

NXITJA APOSTOLIKE

## **GAUDETE ET EXSULTATE**

### **(GËZONI E GALDONI)**

E ATIT TË SHENJTË  
**FRANÇESKUT**

MBI THIRRJEN NË SHENJTËRI  
NË BOTËN BASHKËKOHORE

1. «Gëzohuni e galdoni» (*Mt 5,12*), u thotë Jezusi atyre që janë të përndjekur apo të poshtëruar për shkak të tij. Zoti kërkon gjithçka, dhe ajo që jep është jeta e vërtetë, lumturia për të cilën jemi krijuar. Ai na do të shenjtë dhe nuk pret që të kënaqemi me një ekzistencë mediokre, të mekët, të pavlerë. Në të vërtetë, që prej faqeve të para të Biblës, në mënyra të ndryshme, është e pranishme thirrja në shenjtëri. Kështu ia propozonte Zoti Abrahamit: «Ec para meje dhe ji i përsosur!» (*Zan 17,1*).

2. Nuk duhet të pritët këtu një traktat mbi shenjtërinë, me shumë përkufizime dhe dallime që do të mund ta pasuronin këtë temë të rëndësishme, ose me analiza që do të mund të bëheshin në lidhje me mjetet e shenjtërimit. Objektivi im i përvuajtur është që të bëj të jehojë edhe një herë thirrja në shenjtëri, duke u përpjekur ta mishërojmë atë në kontekstin aktual, me rreziqet e veta, me sfidat dhe mundësitë e veta. Sepse Zoti e ka zgjedhur secilin prej nesh «që të jemi të shenjtë e të papërlyer para Tij në dashuri» (*Ef 1,4*).

## **KAPITULLI I PARË**

### **THIRRJA NË SHENJTËRI**

#### **Shenjtërit që na nxisin dhe na shoqërojnë**

3. Në Letrën drejtuar Hebrenjve përmenden disa dëshmitarë që na nxisin «të vrapojmë me qëndresë në luftimin që na u caktua» (*12,1*). Aty flitet për Abrahamin, për Sarën, për Moisiun, për Gjideonin si edhe për të tjerë (cfr *11,1-12,3*) dhe sidomos jemi të ftuar të pranojmë se jemi «të rrethuar me një re kaq të madhe dëshmitarësh» (*12,1*) që na shtyjnë të mos ndalemi rrugës, na nxisin të vazhdojmë të ecim drejt cakut. Dhe mes tyre mund të jetë edhe vetë nëna jonë, një gjyshe apo persona të tjerë afër nesh (krh. *2 Tim 1,5*). Ndoshta jeta e tyre nuk ka qenë gjithmonë e përsosur, por, edhe në mes të papërsosurive dhe rrëzimeve, kanë vazhduar të ecin përpara dhe i kanë pëlqyer Zotit.

4. Shenjtërit që tashmë kanë mbërritur në praninë e Hyjit ruajnë me ne lidhje dashurie e bashkimi. E vërteton këtë libri i Zbulesës kur flet për martirët që ndërmjetësojnë: «Pashë nën lter shpirtrat e vvarë për shkak të fjalës së Hyjit dhe për shkak të dëshmisë që kishin bërë. Ata bërtisnin me zë të fortë dhe thoshin: "Deri kur, o Zotërues i shenjtë e i drejtë, do të vonosh të bësh drejtësi?"» (6,9-10). Mund të themi se «jemi të rrethuar, të drejtuar e të udhëhequr prej miqve të Hyjit. [...] Nuk duhet ta bart vetëm atë që në të vërtetë nuk do të mund ta bartja kurrë vetëm. Radha e shenjtërve të Hyjit më mbron, më përkrah e më bart».[1]

5. Në proceset e lumturimit dhe kanonizimit merren në konsideratë shenjat e heroizmit në ushtrimin e virtyteve, fljimi i jetës në martirizim si dhe rastet në të cilat ka ndodhur një dhurim i jetës për të tjerët, që është ruajtur deri në vdekje. Ky dhurim shpreh një imitim shembullor të Krishtit, dhe është i denjë për admirimin e besimtarëve.[2] Le të kujtojmë, për shembull, të lumen Maria Gabriella Sagheddu, që ka dhuruar jetën e vet për bashkimin e të krishterëve.

### **Shenjtërit e derës afër nesh**

6. Të mos mendojmë vetëm për ata që tashmë janë lumnuar apo shenjtëruar. Shpirti Shenjt derdh shenjtëri kudo në popullin e shenjtë besnik ndaj Hyjit, sepse «Hyji deshi t'i shenjtëronte dhe t'i shëlbonte njerëzit jo individualisht dhe pa asnjë lidhje mes tyre, por deshi të formonte me ta një popull, që Ta njihte sipas së vërtetës dhe T'i shërbente në shenjtëri».[3] Zoti, në historinë e shëlbimit, ka shëlbuar një popull. Nuk ekziston identitet i plotë pa përkatësi në një popull. Prandaj askush nuk shëlbohet vetëm, si individ i izoluar, por Hyji na tërheq duke mbajtur parasysht rrjetin e ndërlikuar të marrëdhënieve ndërpersonale që krijohen në bashkësinë njerëzore: Hyji ka dashur të hyjë në një dinamikë popullore, në dinamikën e një populli.

7. Më pëlqen ta shoh shenjtërinë në popullin e Hyjit të durueshme: në prindërit që rrisin me shumë dashuri bijtë e tyre, në burrat dhe në gratë që punojnë për të çuar bukën në shtëpi, në të sëmuret, në rregulltaret e moshuara që vazhdojnë të buzëqeshin. Në këtë vendosmëri për të ecur përpara ditë pas dite shoh shenjtërinë e Kishës militante. Kjo është shumë herë shenjtëria "e derës afër nesh", e atyre që jetojnë afër nesh dhe janë një pasqyrim i pranisë së Hyjit, ose, për të përdorur një shprehje tjetër, "klasa e mesme e shenjtërisë".[4]

8. Le të lejojmë të na nxisin shenjat e shenjtërisë që Zoti na paraqet nëpërmjet anëtarëve më të përvuajtur të atij populli që «merr pjesë edhe në shërbesën profetike të Krishtit duke përhapur kudo dëshminë e gjallë për Të, mbi të gjitha nëpërmjet një jete feje dhe dashurie».[5] Le të mendojmë, siç na sugjeron shenjtja Tereza Benedikta e Kryqit, se nëpërmjet shumë prej tyre ndërtohet historia e vërtetë: «Në natën më të errët lindin profetët dhe shenjtërit më të mëdhenj. Megjithatë, rryma gjallëruese e jetës mistike mbetet e padukshme. Sigurisht, ngjarjet vendimtare të historisë së botës janë ndikuar thelbësisht prej shpirtrave për të cilët asgjë nuk thuhet në librat e historisë. Dhe se cilët janë shpirtrat që duhet të falënderojmë për ngjarjet vendimtare të jetës sonë personale, është diçka që do ta dimë vetëm në ditën në të cilën gjithçka që është e fshehur do të zbulohet».[6]

9. Shenjtëria është fytyra më e bukur e Kishës. Por edhe jashtë Kishës Katolike dhe në fusha shumë të ndryshme, Shpirti nxit «shenja të pranisë së tij, që i ndihmojnë edhe vetë nxënësit e Krishtit».[7] Nga ana tjetër, shën Gjon Pali II na ka kujtuar se «dëshmia e bërë Krishtit deri në derdhjen e gjakut është bërë trashëgimi e përbashkët e katolikëve, ortodoksëve, anglikanëve dhe protestantëve».[8] Në përkujtimin e bukur ekumenik që ai dëshiroi të

kremtonte në Koloseum gjatë Jubileut të vitit 2000, tha se martirët janë «një trashëgimi që flet me një zë më të lartë se faktorët e ndarjes».[9]

## Zoti thërret

10. E gjithë kjo është e rëndësishme. Megjithatë, ajo që do të doja të kujtoja me këtë Nxitje është sidomos thirrja në shenjtëri që Zoti i bën secilit prej nesh, ajo thirrje që ta drejton edhe ty: «Të jeni të shenjtë sikurse edhe unë jam i shenjtë» (*Lev 11,44; 1 Pjt 1,16*). Koncili II i Vatikanit e ka vënë këtë në pah me forcë: «Të pajisur me mjete shpëtimi kaq të bollshme dhe kaq të mëdha, të gjithë besimtarët të çdo pozite dhe shtrese janë të thirrur nga Zoti, secili sipas thirrjes së vet, ndaj një shenjtërie përsosuria e së cilës është ajo vetë e Atit qiellor».[10]

11. «Secili sipas thirrjes së vet», thotë Koncili. Pra, nuk është rasti të shkurajohemi kur sodisim modele shenjtërie që duken të paarrtshme. Ka dëshmi që janë të dobishme për të na nxitur dhe motivuar, por jo sepse përpiqemi t'i kopjojmë, sepse kjo madje do të mund edhe të na largonte prej udhës së vetme e specifike që Zoti ka në mend për ne. Ajo që ka rëndësi është që secili besimtar të shohisë rrugën e vet dhe të bëjë që të dalë në pah më e mira e vetvetes, ajo gjë aq personale që Hyji ka vënë në të (krh. *1 Kor 12,7*) dhe jo që të shterojë duke u përpjekur të imitojë diçka që nuk është menduar për të. Të gjithë jemi të thirrur të jemi dëshmitarë, por ekzistojnë shumë forma ekzistenciale dëshmie.[11] Faktikisht, kur mistiku i madh shën Gjoni i Kryqit shkruante veprën e vet *Kënga shpirtërore*, parapëlqente të shmangte rregulla të përcaktuara për të gjithë dhe shpjegonte se rreshtat e tij ishin shkruar në mënyrë që secili të nxirrte dobi prej tyre «në mënyrën e vet».[12] Sepse jeta hyjnore u komunikohet disave në një mënyrë dhe të tjerëve në një mënyrë tjetër.[13]

12. Mes formave të ndryshme, dua të theksoj se edhe "gjenia femërore" dëftohet në stile femërore shenjtërie, të domosdoshme për të reflektuar shenjtërinë e Hyjit në këtë botë. Dhe pikërisht edhe në epoka në të cilat gratë kanë qenë më së shumti të përjashtuara, Shpirti Shenjt ka nxitur shenjtëresha tërheqja e të cilave ka shkaktuar dinamizma të reja shpirtërore dhe reforma të rëndësishme në Kishë. Mund të përmendim shenjten Ildegarda të Bingenit, shenjten Brixhida, shenjten Katerinë nga Siena, shenjten Terezë të Avilës apo shenjten Terezë të Lisjësë. Por dëshiroj të kujtoj shumë gra të panjohura apo të harruara të cilat, secila në mënyrën e vet, kanë mbajtur dhe shndërruar familje e bashkësi me forcën e dëshmisë së tyre.

13. Kjo duhet të entuziazmojë dhe të nxisë secilin për të dhënë gjithë vetveten, për t'u rritur drejt atij projekti të vetëm e të papërsëritshëm që Hyji ka dashur për të që prej gjithë amshimit: «"Para se të të trajtoja në kraharorin amënor, të njoha e, para se të dilje nga gjiri amënor, të shenjtërova» (*Jer 1,5*).

## Edhe për ty

14. Për të qenë të shenjtë nuk është e nevojshme të jesh ipeshkëv, meshtar, rregulltare apo rregulltar. Shumë herë kemi tundimin të mendojmë se shenjtëria është e rezervuar vetëm për ata që kanë mundësinë të rrinë larg prej punëve të zakonshme, për t'i kushtuar shumë kohë lutjes. Nuk është kështu. Të gjithë jemi të thirrur të jemi të shenjtë duke jetuar me dashuri dhe duke dhënë secili dëshminë e vet në punët e përditshme, aty ku ndodhet. A je një e kushtuar Zotit apo një i kushtuar Zotit? Ji i shenjtë duke e jetuar me gëzim dhurimin tënd. Je i martuar? Ji i shenjtë duke dashur e duke u kujdesur për burrin tënd apo gruan tënde, ashtu sikurse Krishti ka bërë me Kishën. Je punëtor? Ji i shenjtë duke e bërë me ndershmeri dhe kompetencë punën tënde në shërbim të vëllezërve. Je prind apo gjyshe apo

gjysh? Ji i shenjtë duke u mësuar me durim fëmijëve që të ndjekin Jezusin. Ke autoritet? Ji i shenjtë duke luftuar në dobi të së mirës së përbashkët dhe duke hequr dorë prej interesave të tua personale.[14]

15. Lejo që hiri i Pagëzimit tënd të japë fryte në një ecje shenjtërie! Lejo që gjithçka të jetë e hapur ndaj Hyjit dhe për këtë qëllim të zgjedhë Ai, zgjedh Hyjin përsëri e përsëri! Mos u shkurajo, sepse ke fuqinë e Shpirtit Shenjt në mënyrë që kjo të jetë e mundur, dhe shenjtëria, në fund të fundit, është fryti i Shpirtit Shenjt në jetën tënde (krh. *Gal* 5,22-23). Kur ndien tundimin që të ngecësh në dobësinë tënde, çoji sytë nga i Kryqëzuari dhe thuaji: "O Zot, unë jam një i shkretë, por ti mund të bësh mrekullinë që të bëhem pak më i mirë". Në Kishën, e shenjtë dhe të përbërë prej mëkatarësh, do të gjesh gjithçka që të nevojitet për t'u rritur drejt shenjtërisë. Zoti e ka mbushur atë me dhurata, me Fjalën, Sakramentet, shenjtëroret, jetën e bashkësive, dëshminë e shenjtërve, si dhe një bukuri shumëformëshe që rrjedh prej dashurisë së Zotit, «porsi nuse me argëndari e stolitur» (*Is* 61,10).

16. Kjo shenjtëri në të cilën Zoti të thërret do të rritet nëpërmjet gjestesh të vogla. Për shembull: një zonjë shkon në treg për të blerë, takon një fqinjë e fillon të flasë, dhe fillojnë kritikën. Por kjo grua thotë brenda vetvetes: "Jo, nuk do të flas keq për askënd!". Ky është një hap drejt shenjtërisë. Pastaj, në shtëpi, i biri i kërkon të flasë për fantazitë e veta dhe, edhe pse është e lodhur, ulet pranë tij dhe dëgjon me durim e dashuri. Ja një tjetër flijim që shenjtëron. Pastaj përjeton një moment ankthi, por kujton dashurinë e Virgjërës Mari, merr rruzaren dhe lutet me fe. Kjo është një tjetër udhë e shenjtërisë. Pastaj del në rrugë, takon një të varfër dhe ndalet të bisedojë me të me dashuri. Edhe ky është një hap përpara.

17. Nganjëherë jeta paraqet sfida më të mëdha dhe nëpërmjet këtyre Zoti na fton në kthime të reja që i lejojnë hirit të tij të dëftohet më mirë në ekzistencën tonë «me qëllim që të na japë shenjtërinë e vet» (*Heb* 12,10). Herë të tjera bëhet fjalë vetëm që të gjejmë një mënyrë më të përsosur për ta jetuar atë që tashmë bëjmë: «Ka frymëzime që priren vetëm nga një përsosje e jashtëzakonshme e ushtrimeve të zakonshme të jetës së krishterë».[15] Kur Kardinali Françesk Saver Nguyễn Van Thuân ishte në burg, hoqi dorë nga konsumimi i vetvetes duke pritur lirim. Zgjedhja e tij qe: «Jetoj momentin e tashëm, duke e mbushur atë me dashuri»; dhe mënyra me të cilën konkretizohej kjo ishte: «Shfrytëzoj rastet që paraqiten çdo ditë, për të bërë veprime të zakonshme në mënyrë të jashtëzakonshme».[16]

18. Kështu, nën shtytjen e hirit hyjnor, me shumë gjeste fillojmë të ndërtojmë atë figurë shenjtërie që Hyji ka dashur për ne, por jo si qenie të vetëmjaftueshme, por «si mbarështues të mirë të hirit të shumëllojshëm të Hyjit» (*1 Pjt* 4,10). Mirë kanë mësuar Iveshkvijtë e Zelandës së Re se është e mundur të duam me dashurinë e pakushtëzuar të Zotit sepse i Ringjalluri e bashkëndan jetën e vet të fuqishme me jetët tona të brishta: «Dashuria e tij nuk ka kufij dhe kur është dhuruar një herë, nuk është tërhequr kurrë prapa. Ka qenë e pakushtëzuar dhe ka mbetur besnike. Të duash kështu nuk është e lehtë sepse shumë herë jemi shumë të dobët. Por, pikërisht që të mund të duam ashtu sikurse Ai na ka dashur, Krishti bashkëndan jetën e vet të ringjallur me ne. Në këtë mënyrë, jeta jonë dëfton fuqinë e tij në veprim, edhe në mes të dobësisë njerëzore».[17]

## Misioni yt në Krishtin

19. Për një të krishterë nuk është e mundur ta mendojë misionin e vet mbi tokë pa e konceptuar atë si një ecje shenjtërie, sepse «Vullneti i Hyjit është ky: shenjtërimi juaj» (*1 Sel* 4,3). Çdo shenjtëri është një mision; është një projekt i Atit për të reflektuar e mishëruar, në një moment të caktuar të historisë, një aspekt të Ungjillit.

20. Ky mision gjen plotësi kuptimi në Krishtin dhe mund të kuptohet vetëm duke nisur prej Tij. Në fund të fundit, shenjtëri do të thotë të jetojmë në bashkim me Të misteret e jetës së tij. Shenjtëria përbëhet në bashkimin me vdekjen dhe ringjalljen e Zotërisë në mënyrë unikale dhe personale, në vdekjen dhe ringjalljen vazhdimisht bashkë me Të. Por mund të kërkojë edhe që të riprodhojmë në ekzistencën tonë aspekte të ndryshme të jetës tokësore të Jezusit: jetën e fshehur, jetën bashkësiore, afërsinë me të fundit e shoqërisë, varfërinë dhe dëftime të tjera të dhurimit të tij për dashuri. Soditja e këtyre mistereve, sikurse propozonte shën Injaci i Lojolës, na orienton për t'i mishëruar ato në zgjedhjet tona dhe në qëndrimet tona.[18] Sepse «gjithçka në jetën e Jezusit është shenjë e misterit të tij»,[19] «e gjithë jeta e Krishtit është Dëftim i Atit»,[20] «e gjithë jeta e Krishtit është mister i Shëlbimit»,[21] «e gjithë jeta e Krishtit është mister i përmbledhjes së gjithçkaje nën kryesinë e Tij»,[22] e gjithçka që Krishti ka jetuar bën që ne të mund ta jetojmë në Të dhe që Ai ta jetojë në ne».[23]

21. Plani i Atit është Krishti, dhe ne në Të. Si përfundim, është Krishti ai që do në ne, sepse «shenjtëria nuk është gjë tjetër veçse dashuria e jetuar plotësisht».[24] Prandaj, «masa e shenjtërisë jepet prej lartësisë që Krishti arrin në ne, prej asaj se sa, me fuqinë e Shpirtit Shenjt, e modelojmë gjithë jetën tonë sipas jetës së tij».[25] Kështu, çdo shenjt është një mesazh, që Shpirti Shenjt nxjerr prej pasurisë së Jezu Krishtit dhe ia dhuron popullit të tij.

22. Për të ditur se cila është ajo fjalë që Zoti dëshiron të thotë nëpërmjet një shenjti, nuk është mirë të ndalemi në hollësitë, sepse aty mund të ketë edhe gabime e rrëzime. Jo gjithçka që thotë një shenjt është plotësisht besnike ndaj Ungjillit, jo gjithçka që bën është e njëmendtë dhe e përsosur. Ajo që duhet të sodisim është tërësia e jetës së tij, krejt ecja e tij e shenjtërimit, ajo figurë që reflekton diçka prej Jezu Krishtit dhe që del në pah kur njeriu arrin të formojë kuptimin e tërësisë së personit të tij.[26]

23. Kjo është një thirrje e fortë për të gjithë ne. Edhe ti ke nevojë ta konceptosh tërësinë e jetës tënde si një mision. Provo ta bësh këtë duke dëgjuar Hyjin në lutje dhe duke njohur shenjat që Ai të jep. Kërkoji gjithmonë Shpirtit se çfarë pret Jezusi prej teje në çdo moment të ekzistencës tënde dhe në çdo zgjedhje që duhet të bësh, për të kuptuar vendin që kjo zë në misionin tënd. Dhe lejoji të mbrujë në ty atë mister personal që mund të reflektojë Jezu Krishtin në botën e sotme.

24. Dhashtë Zoti që ti të mund të dish se cila është ajo fjalë, ai mesazh i Jezusit që Hyji dëshiron t'ia komunikojë botës me jetën tënde. Lejo të shndërrohesh, lejo të përtërihesh prej Shpirtit, në mënyrë që kjo të jetë e mundur, dhe kështu misioni yt i çmueshëm nuk do të shkojë kot. Zoti do ta çojë atë në plotësi edhe në mes të gabimeve të tua dhe momenteve të tua negative, mjafton që ti të mos e braktisësh rrugën e dashurisë dhe të mbetesh gjithmonë i hapur ndaj veprimit të tij mbinatyror që pastron dhe ndriçon.

### **Veprimtaria që shenjtëron**

25. Meqenëse nuk mund të kuptohet Krishti pa Mbretërinë që Ai ka ardhur të sjellë, vetë misioni yt është i pandashëm prej ndërtimit të Mbretërisë: «Kërkoni, pra, më së pari, Mbretërinë dhe drejtësinë e tij!» (Mt 6,33). Identifikimi yt me Krishtin dhe me dëshirat e tij kërkon angazhimin për të ndërtuar, së bashku me Të, këtë Mbretëri dashurie, drejtësie dhe paqeje për të gjithë. Vetë Krishti dëshiron ta jetojë bashkë me ty, në të gjitha përpjekjet dhe vetëmohimet e nevojshme, si edhe në gëzimet dhe në frytshmërinë që do të mund të të dhurojë. Prandaj, nuk do të shenjtërohesh pa u dhuruar me trup e me shpirt për të dhënë maksimumin e vetvetes në këtë angazhim.

26. Nuk është gjë e mirë të duam heshtjen dhe të shmangim takimin me të tjerët, të dëshirojmë pushimin dhe të mos pranojmë veprimtarinë, të kërkojmë lutjen dhe të nënvleftësojmë shërbimin. Gjithçka mund të pranohet dhe të përfshihet si pjesë e ekzistencës sonë në këtë botë, dhe bën pjesë në ecjen e shenjtërimit. Jemi të thirrur të jetojmë seditjen edhe në mes të veprimit, dhe shenjtërohemi në ushtrimin e përgjegjshëm e bujar të misionit tonë.

27. Mos ndoshta Shpirti Shenjt mund të na dërgojë për të kryer një mision dhe në të njëjtën kohë të na kërkojë të ikim prej tij, apo të mos dhurohemi tërësisht për të ruajtur paqen e brendshme? Megjithatë, nganjëherë kemi tundimin t'i vëmë përkushtimin baritor dhe angazhimin në botë në një vend dytësor, sikur të ishin "shpërqendrime" në ecjen e shenjtërisë dhe të paqes së brendshme. Harrojmë se «nuk është se jeta ka një mision, por ajo është mision».[27]

28. Një angazhim i nxitur prej ankthit, prej krenarisë, prej nevojës për t'u dukur e për të sunduar, me siguri nuk do të jetë shenjtërues. Sfida është ta jetojmë dhurimin tonë në mënyrë të tillë që përpjekjet të kenë një kuptim ungjillor dhe të na identifikojnë gjithnjë e më shumë me Jezun Krishtin. Prandaj flitet shpesh, për shembull, për një përshtirë të katekistit, për një përshtirë të klerit dioqezan, për një përshtirë të punës. Për të njëjtën arsye, në *Gëzimi i Ungjillit* kam dashur të përfundoj me një përshtirë të misionit, në *Ti qofsh lëvduar* me një përshtirë ekologjike dhe në *Gëzimi i dashurisë* me një përshtirë të jetës familjare.

29. Kjo nuk do të thotë të përbuzim momentet e qetësisë, vetmisë dhe heshtjes para Hyjit. Përkundrazi. Sepse risitë e vazhdueshme të mjeteve teknologjike, tërheqja e udhëtimeve, ofertat e panumërta të konsumit, nganjëherë nuk lënë hapësira të zbrazëta në të cilat të jehojë zëri i Hyjit. Gjithçka mbushet me fjalë, me kënaqësi epidermike dhe me zhurma në një shpejtësi gjithnjë e më të madhe. Aty nuk mbretëron gëzimi por pakënaqësia e atij që nuk di se për çfarë jeton. Prandaj, si të mos pranojmë se kemi nevojë ta ndalim këtë vrapim të ethshëm për të rifituar një hapësirë personale, nganjëherë të dhimbshme por gjithmonë të frytshme, në të cilën nis dialogu i sinqertë me Hyjin? Në ndonjë moment duhet të shikojmë në fytyrë të vërtetën e vetvetes, për ta lënë atë të pushtohet prej Zotit, dhe jo gjithmonë arrihet kjo nëse njeriu «nuk gjendet në buzë të greminës, të tundimit më të rëndë, në sharrnajën e braktisjes, në majën e vetmuar ku ka përshtypjen se mbetet krejtësisht vetëm».[28] Në këtë mënyrë gjejmë motivimet e mëdha që na nxisin t'i jetojmë deri në fund detyrat tona.

30. Vetë mjetet e argëtimit që e pushtojnë jetën aktuale na bëjnë edhe ta absolutizojmë kohën e lirë, në të cilën mund t'i përdorim pa kufizim ata mekanizma që na ofrojnë argëtim dhe kënaqësi kalimtare.[29] Si rrjedhojë, është misioni ynë ai që i ndien pasojat, është angazhimi ai që dobësohet, është shërbimi zemërgjerë dhe i gatshëm ai që fillon të pakësohet. Kjo e përçudnon përvojën shpirtërore. A mund të jetë i shëndoshë një zell shpirtëror që bashkëjeton me dembelinë në veprimin ungjillëzues apo në shërbimin ndaj të tjerëve?

31. Na nevojitet një shpirt shenjtërie që mbush si vetminë ashtu edhe shërbimin, si intimitetin ashtu edhe angazhimin ungjillëzues, në mënyrë që çdo çast të jetë shprehje dashurie e dhuruar para syve të Zotit. Në këtë mënyrë, të gjitha momentet do të jenë shkallë në jetën tonë të shenjtërimit.

**Më të gjallë, më njerëzorë**

32. Mos ki frikë nga shenjtëria! Nuk do të të heqë forcat, jetën dhe gëzimin. Krejt e kundërta, sepse do të arrish të jesh ai që Ati ka menduar kur të ka krijuar dhe do të jesh besnik ndaj vetë qenies tënde. Të varurit prej Tij na liron prej skllavërisë dhe na bën të njohim dinjitetin tonë. Ky realitet reflektohet në shenjten Xhyzepina Bakhita, që «e bënë skllave dhe e shitën si të tillë në moshën e njomë shtatë vjeçare, vuajti shumë në duart e pronarëve mizorë. Megjithatë, kuptoi të vërtetën e thellë se Hyji, dhe jo njeriu, është zotëria i vërtetë i çdo qenieje njerëzore, i çdo jete njerëzore. Kjo përvojë u bë burim urtie të madhe për këtë bijë të përvuajtur të Afrikës».[30]

33. Çdo i krishterë, në masën në të cilën shenjtërohet, bëhet më i frytshëm për botën. Ipushkuvijtë e Afrikës Perëndimore na kanë mësuar: «Jemi të thirrur, në shpirtin e ungjillëzimit të ri, që të ungjillëzohemi dhe që të ungjillëzojmë nëpërmjet promovimit të të gjithë të pagëzuarve, me qëllim që të merrni përsipër rolet tuaja si kripë e tokës dhe dritë e botës kudo që të gjendeni».[31]

34. Mos ki frikë që të synosh më lart, që ta lejosh Hyjin të të dojë dhe të të lirojë! Mos ki frikë të lejosh të të udhëheqë Shpirti Shenjt! Shenjtëria nuk të bën më pak njerëzor, sepse është takimi i dobësisë tënde me forcën e hirit. Në fund të fundit, siç thoshte León Bloy, në jetë «nuk ka tjetër veçse një trishtim, [...] ai se nuk jemi të shenjtë».[32]

## KAPITULLI I DYTË

### DY MIQ TË FSHEHTË TË SHENJTËRISË

35. Në këtë kuadër, dëshiroj të tërheq vëmendjen mbi dy falsifikime të shenjtërisë që mund të na bëjnë të gabojmë rrugë: gnosticizmi dhe pelagianizmi. Janë dy herezi të lindura në shekujt e parë të krishterë, por që vazhdojnë të kenë një aktualitet alarmues. Edhe sot zemrat e shumë të krishterëve, ndoshta pa qenë të vetëdijshme për këtë, lejojnë të joshen prej këtyre propozimeve mashtruese. Në ta shprehet një imanentizëm antropocentrik i maskuar si e vërtetë katolike.[33] Le t'i shohim këto dy forma të sigurisë doktrimore apo disiplinore që i hapin udhë «një elitarizmi narcizist dhe autoritar ku, në vend që të ungjillëzohet, analizohen dhe klasifikohen të tjerët, dhe në vend që të lehtësohet marrja e hirit konsumohen energjitë në kontroll. Në të dyja rastet, as Jezu Krishti as të tjerët nuk interesojnë me të vërtetë».[34]

#### **Gnosticizmi aktual**

36. Gnosticizmi supozon «një fe të mbyllur në subjektivizëm, ku personit i intereson vetëm një përvojë e caktuar apo një seri arsyesimesh e njohurish që mendon se mund të ngushëllojnë dhe të ndriçojnë, por ku subjekti në fund të fundit mbetet i mbyllur në imanencën e arsyes së vet dhe të ndjenjave të veta».[35]

*Një mendje pa Hyj e pa trup*

37. Falë Hyjit, gjatë historisë së Kishës ka dalë shumë qartë se ajo që mat përsosurinë e personave është shkalla e tyre e dashurisë, jo sasia e të dhënave dhe e njohurive që mund të grumbullojnë. "Gnostikët" krijojnë pështjellim në lidhje me këtë pikë dhe i gjejnë të

tjerët në bazë të verifikimit të aftësisë së tyre për të kuptuar thellësinë e doktrinave të caktuara. Konceptojnë një mendje pa mishërim, të paaftë për të takuar trupin e vuajtur të Krishtit në të tjerët, të ngurtësuar në një enciklopedi abstraksionesh. Në fund, duke çmishëruar misterin, parapëlqejnë «një Hyj pa Krishtin, një Krisht pa Kishën, një Kishë pa popull».[36]

38. Si përfundim, bëhet fjalë për një sipërfaqësi krenare: shumë lëvizje në sipërfaqen e mendjes, por nuk lëviz e nuk preket thellësia e mendimit. Megjithatë, arrin t'i nënshtrojë disa me një joshje mashtruese, sepse ekuilibri gnostik është formal dhe pretendon se është aseptik, dhe mund të marrë pamjen e njëfarë harmonie apo atë të një rendi që përfshin gjithçka.

39. Por, të kemi kujdes! Nuk e kam fjalën për racionalistët armiq të fesë së krishterë. Kjo mund të ndodhë brenda Kishës, si mes laikëve të famullive ashtu edhe mes atyre që japin mësim filozofie apo teologjie në qendrat e formimit. Sepse është tipike e agnosticëve edhe të mendojnë se me shpjegimet e tyre mund ta bëjnë krejtësisht të kuptueshme gjithë fenë dhe gjithë Ungjillin. I absolutizojnë teoritë e tyre dhe i detyrojnë të tjerët t'u nënshtrohen arsytimeve të tyre. Një gjë është një përdorim i shëndoshë dhe i përvuajtur i arsyes për të reflektuar në lidhje me mësimin teologjik e moral të Ungjillit; një gjë tjetër është të pretendojmë ta kthejmë mësimin e Jezusit në një logjikë të ftohtë e të ashpër që përpiqet të sundojë gjithçka.[37]

#### *Një doktrinë pa mister*

40. Gnosticizmi është një ndër ideologjitë më të këqija, sepse, ndërsa lartëson pa të drejtë njohjen apo një përvojë të caktuar, mendon se vizioni i vet i realitetit është i përsosur. Në këtë mënyrë, ndoshta pa e kuptuar, kjo ideologji vetëushqehet dhe bëhet edhe më e verbër. Nganjëherë bëhet veçanërisht mashtruese kur maskohet si përshpirtëri e çmishëruar. Në të vërtetë, gnosticizmi «për vetë natyrën e vet dëshiron ta zbusë misterin»,[38] si misterin e Hyjit dhe të hirit të tij, ashtu edhe misterin e jetës së të tjerëve.

41. Kur dikush ka përgjigje për të gjitha pyetjet, tregon se gjendet në një rrugë jo të mirë dhe është e mundur që të jetë një profet i rremë, që e përdor besimin në dobi të vet, në shërbim të bluarjeve të veta psikologjike e mendore. Hyji na tejkalon pafundësisht, është gjithmonë një befasi dhe nuk jemi ne ata që përcaktojnë se në çfarë rrethane historike ta gjejmë, meqenëse nuk varen prej nesh koha, vendi dhe modaliteti i takimit. Ai që dëshiron që gjithçka të jetë e qartë dhe e sigurt pretendon të sundojë transhendencën e Hyjit.

42. As nuk mund të pretendohet të përkufizohet se ku nuk gjendet Hyji, sepse Ai është në mënyrë të mistershme i pranishëm në jetën e çdo personi, në jetën e secilit ashtu sikurse Ai dëshiron, dhe nuk mund ta mohojmë me siguritë tona të hamendësuar. Edhe nëse ekzistenca e dikujt ka qenë një katastrofë, edhe kur e shohim të shkatërruar prej veseve apo prej varësive, Hyji është i pranishëm në jetën e tij. Nëse lejojmë të udhëhiqemi prej Shpirtit më shumë se sa prej arsytimeve tona, mund dhe duhet të kërkojmë Zotin në çdo jetë njerëzore. Kjo bën pjesë në misterin që mendësitë gnosticike arrijnë të mos e pranojnë, sepse nuk mund ta kontrollojnë.

#### *Kufizimet e arsyes*

43. Ne arrijmë ta kuptojmë në mënyrë shumë të varfër të vërtetën që marrim prej Zotit. Dhe me vështirësi edhe më të madhe arrijmë ta shprehim. Prandaj nuk mund të pretendojmë se mënyra jonë për ta kuptuar atë na autorizon të ushtrojmë një kontroll të fortë mbi jetën e të



tjerëve. Dua të kujtoj se në Kishë bashkëjetojnë në mënyrë të ligjshme mënyra të ndryshme të interpretimit të shumë aspekteve të doktrinës dhe të jetës së krishterë që, në larminë e tyre, «ndihmojnë për ta shtjelluar më mirë thesarin tejet të pasur të Fjalës». Sigurisht, «atyre që ëndërrojnë një doktrinë monolitike të mbrojtur nga të gjithë pa tonalitet, kjo mund t'ju duket një hallakatje e papërsosur».[39] Pikërisht, disa rryma gnostike e kanë përbuzur thjeshtësinë aq konkrete të Ungjillit dhe kanë bërë përpjekje ta zëvendësojnë Hyjin trinitar e të mishëruar me një Njësi të epërme në të cilën zhdukej larmia e pasur e historisë sonë.

44. Në të vërtetë, doktrina, ose më mirë të themi, kuptimi dhe shprehja që ne i japim asaj, «nuk është një sistem i mbyllur, pa dinamika të afta të shkaktojnë pyetje, dyshime, pikëpyetje», dhe «pyetjet e popullit tonë, mundimet e tij, betejat e tij, ëndrrat e tij, luftërat e tij, shqetësimet e tij, kanë një vlerë hermeneutike që nuk mund ta shpërfillim nëse duam ta marrim seriozisht parimin e mishërimit. Pyetjet e tij na ndihmojnë të pyesim vetveten, pikëpyetjet e tij na bëjnë pyetje ne».[40]

45. Shpesh ndodh një ngatërrim i rrezikshëm: të besojmë se, meqenëse dimë diçka ose mund ta shpjegojmë atë me njëfarë logjike, tashmë jemi të shenjtë të përkryer, më të mirë sesa "masa e paditur". Shën Gjon Pali II i paralajmëronte ata që në Kishë kanë mundësinë e një formimi më të madh që të ruhen nga tundimi i zhvillimit të «një ndjenje superioriteti kundrejt besimtarëve të tjerë».[41] Por, në të vërtetë, ajo që mendojmë se dimë duhet të përbëjë gjithmonë një motivim për t'ju përgjigjur më mirë dashurisë së Hyjit, sepse «mësojmë për të jetuar: teologjia dhe shenjtëria janë një binom i pandashëm».[42]

46. Kur shën Françesku i Asizit pa se disa nga nxënësit e tij u mësonin të tjerëve doktrinën, dëshiroi ta shmangte tundimin e gnosticizmit. Prandaj i shkroi kështu Shën Antonit të Padovës: «Më vjen mirë që ti u mëson teologjinë e shenjtë fretërve, mjafton që, në këtë punë, ti të mos e shuash shpirtin e uratës dhe të devocionit».[43] Ai e njihte tundimin për ta shndërruar përvojën e krishterë në një tërësi përpunimesh mendore që arrijnë të na largojnë prej freskisë së Ungjillit. Shën Bonaventura, nga ana e vet, paralajmëronte se urtia e vërtetë e krishterë nuk duhet të ndahet prej mëshirës ndaj të afërmit: «Urtia më e madhe që mund të ekzistojë është ta dhurojmë me fryt atë që kemi, dhe që e kemi marrë pikërisht që ta dhuronim. [...] Prandaj, ashtu sikurse mëshira është mike e urtisë, po ashtu kopracia është armike e saj».[44] «Ekzistojnë veprimtari që, duke u bashkuar me soditjen, nuk e pengojnë atë, por e ndihmojnë, ashtu si veprat e mëshirshme».[45]

## **Pelagianizmi aktual**

47. Gnosticizmi i ka hapur udhë një herezie tjetër të vjetër, edhe ajo e pranishme sot. Me kalimin e kohës, shumë vetë filluan të pranonin se nuk është njohja ajo që na bën më të mirë apo shenjtër, por jeta që bëjmë. Problemi është se kjo degjeneroi pa u ndier, në mënyrë të tillë që vetë gabimi i gnosticëve thjesht u shndërrua, por nuk u kapërcye.

48. Në të vërtetë, pushtetin që gnostikët i njihnin inteligjencës, disa filluan t'ia njihnin vullnetit njerëzor, përpjekjes personale. Kështu lindën pelagianët dhe gjysëmpelagianët. Nuk ishte më inteligjenca ajo që zinte vendin e misterit dhe të hirit, por vullneti. Harronin se gjithçka «nuk është puna e atij që do ose e atij që sulet, por e Hyjit që bën mëshirë» (*Rom 9,16*) dhe se Ai «na deshi më parë» (*1 Gjn 4,19*).

*Një vullnet pa përvujtëri*

49. Ata që i përgjigjen kësaj mendësie pelagiane apo gjysëmpelagiane, megjithëse flasin për hirin e Hyjit me fjalime të zbutura, «në fund të fundit mbështeten vetëm në forcat e veta dhe ndihen më lart se të tjerët sepse zbatojnë norma të caktuara apo sepse janë besnikë të patundur ndaj një stili të caktuar katolik».[46] Kur disa prej tyre u drejtohen të dobtëve duke thënë se me hirin e Hyjit gjithçka është e mundur, në fund të fundit e kanë zakon të komunikojnë idenë se gjithçka mund të bëhet me vullnetin njerëzor, a thua se ai është diçka e pastër, e përsosur, e gjithëpushtetshme, së cilës i shtohet hiri. Pretendojnë të shpërfillin faktin se «jo të gjithë munden gjithçka»[47] dhe se në këtë jetë brishtësitë njerëzore nuk shërohen krejtësisht dhe një herë e përgjithonë prej hirit.[48] Në secilin rast, siç mësonte shën Agustini, Hyji të fton të bësh atë që mundesh dhe «të kërkosh atë që nuk mundesh».[49] ose t'i thuash me përvujtëri Zotit: «Ma jep atë që urdhëron dhe më urdhëro çfarë të duash».[50]

50. Në fund të fundit, mungesa e një pranimi të sinqertë, të vuajtur dhe lutës të kufizimeve tona është ajo që e pengon hirin të veprojë më mirë në ne, sepse nuk i lë hapësirë për të shkaktuar atë të mirë të mundshme që integrohet në një ecje të sinqertë dhe reale rritjeje.[51] Hiri, pikërisht sepse **merr parasys** natyrën tonë, nuk na bën papritmas supernjerëz. Ta pretendojmë këtë do të thotë të kemi tepër besim në vetvete. Në këtë rast, pas ortodoksisë, qëndrimet tona mund të mos u përgjigjen atyre që pohojmë në lidhje me nevojën e hirit, dhe në faktet arrijmë t'i besojmë pak atij. Në të vërtetë, nëse nuk e pranojmë realitetin tonë konkret dhe të kufizuar, nuk do të mund t'i shohim as hapat realë dhe të mundshëm që Zoti na kërkon në çdo moment, pasi na ka tërhequr dhe na ka bërë të aftë dhe dhuratën e tij. Hiri vepron historikisht dhe, zakonisht, na merr e na shndërron në mënyrë progresive.[52] Prandaj, nëse nuk e pranojmë këtë modalitet historik e progresiv, faktikisht mund të arrijmë ta mohojmë e ta bllokojmë, edhe pse me fjalët tona e lartësojmë atë.

51. Kur Hyji i drejtohet Abrahamit, i thotë: «Unë jam Hyji i Gjithëpushtetshëm! Ec para meje dhe ji i përsosur!» (*Zan* 17,1). Që të mund të jemi të përsosur, siç i pëlqen Atij, kemi nevojë të jetojmë përvujtërisht në praninë e tij, të mbështjellë në lavdinë e tij; kemi nevojë të ecim në bashkim me Të duke e njohur dashurinë e tij të vazhdueshme në jetën tonë. Duhet ta braktisim frikën nga kjo prani e cila mund të na bëjë vetëm mirë. Është Ati ai që na e ka dhënë jetën dhe na do shumë. Kur e pranojmë atë dhe nuk e mendojmë më ekzistencën tonë pa Të, zhduket ankthi i vetmisë (krh. *Ps* 139,7). Dhe nëse nuk krijojmë më largësi mes nesh e Hyjit dhe jetojmë në praninë e tij, do të mund t'i lejojmë t'i shqyrtojmë zemrat tona për të parë nëse shkojnë rrugës së drejtë (krh. *Ps* 139,23-24). Kështu do ta njohim vullnetin e mrekullueshëm e të përsosur të Zotit (krh. *Rom* 12,1-2) dhe do të lejojmë që Ai të na modelojë si një vorbëtar (krh. *Is* 29,16). Kemi thënë shumë herë se Hyji banon në ne, por është më mirë të themi se ne banojmë në Të, se Ai na lejon të jetojmë në dritën e tij dhe në dashurinë e tij. Ai është koha jonë: «Për një gjë të vetme i lutem Zotit, vetëm atë ia kërkoj, që të jetoj në shtëpinë e Zotit të gjitha ditët e jetës sime» (*Ps* 27,4). «Vërtet, më e mirë është një ditë në Shtëpinë tënde se të tjera me mijëra» (*Ps* 84,11). Në Të shenjtërohemi.

#### *Një mësim i Kishës shpesh i harruar*

52. Kisha ka mësuar shumë herë se nuk shfajësohemi prej veprave tona apo prej përpjekjeve tona, por prej hirit të Zotit i cili merr nismën. Etërit e Kishës, edhe para shën Agustinit, e kanë shprehur qartë këtë bindje parësore. Shën Gjoni i Kryqit pohonte se Hyji derdh në ne vetë burimin e të gjitha dhuratave «para se ne të kemi hyrë në luftim».[53] Shën Bazili i Madh theksonte se besimtari mburret vetëm në Hyjin, sepse «pranon se i mungon drejtësia e vërtetë dhe shfajësohet vetëm nëpërmjet fesë në Krishtin».[54]

53. Sinodi i dytë i Oranzhës ka mësuar me autoritet të patundur se asnjë qenie njerëzore nuk mund të pretendojë, meritojë apo blejë dhuratën e hirit hyjnor, dhe se gjithçka që mund të bashkëpunojë me të është paraprakisht dhuratë e të njëjtit hir: «Madje edhe dëshira që të jemi të pastër aktualizohet në ne nëpërmjet zbritjes dhe veprimit mbi ne të Shpirtit Shenjt».[55] Më tutje Koncili i Trentit, edhe kur theksoi rëndësinë e bashkëpunimit tonë për rritjen shpirtërore, e ripohoi atë mësim dogmatik: «Pohohet se jemi shfajësuar falas, sepse asgjë nga ato që i paraprijnë shfajësimit, si feja, si veprat, nuk meriton vetë hirin e shfajësimit; sepse nëse është hir, atëherë nuk është për veprat; përndryshe hiri nuk do të ishte më hir (*Rom 11,6*)».[56]

54. Edhe Katekizmi i Kishës Katolike na kujton se dhurata e hirit «i tejkalon aftësitë e inteligjencës dhe forcat e vullnetit të njeriut»,[57] dhe se «para Hyjit, në kuptimin e pastër juridik, nuk ka meritë nga ana e njeriut. Mes Tij dhe nesh pabarazia është e pamasë».[58] Miqësia e tij na tejkalon pafundësisht, nuk mund të blihet prej nesh me veprat tona dhe mund të jetë vetëm një dhuratë e nismës së tij të dashurisë. Kjo na fton të jetojmë me mirënjohje të gëzueshme për këtë dhuratë që kurrë nuk do ta meritojmë, meqenëse «kur dikush është në hir, hiri që e ka marrë tashmë nuk mund të jetë i merituar».[59] Shenjtërit nuk e vënë besimin në veprat e tyre: «Në mbrëmjen e kësaj jete, do të shfaqem para teje me duar të zbrazura, sepse nuk të kërkoj, o Zot, t'i numërosh veprat e mia. Çdo drejtësi e jona është e papërsosur para syve të tu».[60]

55. Kjo është një ndër bindjet e mëdha të arritura përfundimisht prej Kishës, dhe është aq qartë e shprehur në Fjalën e Zotit sa mbetet jashtë çdo diskutimi. Ashtu sikurse urdhri më i madh i dashurisë, edhe kjo e vërtetë duhet ta dallojë stilin tonë të jetës, sepse frymëzohet prej zemrës së Ungjillit dhe na thërret jo vetëm ta pranojmë me mendje, por edhe ta shndërrojmë atë në një gëzim infektues. Por, nuk do të mund ta kremtonim me mirënjohje dhuratën falas të miqësisë me Zotin, nëse nuk pranojmë se edhe ekzistenca jonë tokësore dhe aftësitë tona natyrore janë një dhuratë. Kemi nevojë që «të pranojmë me gëzim se realiteti ynë është fryt i një dhurate, dhe ta pranojmë edhe lirinë tonë si hir. Kjo është gjëja e vështirë sot, në një botë që beson se zotëron diçka prej vetvetes, fryt të origjinalitetit dhe lirisë së vet».[61]

56. Vetëm duke nisur prej dhuratës së Hyjit, të pranuar lirisht dhe të marrë përvujtërisht, mund të bashkëpunojmë me përpjekjet tona për të lejuar të shndërrohemi gjithnjë e më shumë.[62] Gjëja e parë është t'i përkasim Hyjit. Bëhet fjalë që t'i kushtohemi Atij që na hershon, t'i kushtojmë aftësitë tona, angazhimin tonë, luftën tonë kundër së keqes dhe krijimtarinë tonë, me qëllim që dhurata e tij falas të rritet dhe të zhvillohet në ne: «Po ju përbej me mëshirën e Hyjit, o vëllezër, ta kushtoni trupin tuaj fli të gjallë, të shenjtë e të pëlqyeshme Hyjit» (*Rom 12,1*). Në fund të fundit, Kisha gjithmonë ka mësuar se vetëm dashuria e bën të mundur rritjen në jetën e hirit, sepse «po të më mungonte dashuria, s'do të isha asgjë» (*1 Kor 13,2*).

### *Pelagianët e rinj*

57. Ka edhe të krishterë që angazhohen duke ndjekur një rrugë tjetër: atë të shfajësimit nëpërmjet forcave të veta, atë të adhurimit të vullnetit njerëzor dhe të aftësisë së vet, që kthehet në një vetëkënaqësi egocentrike dhe elitare pa dashurinë e vërtetë. Shfaqet në shumë qëndrime që në dukje janë të ndryshme mes tyre: obsesioni për ligjin, dëshira për të treguar arritje shoqërore e politike, dëshira për t'u dukur në kujdesin për liturgjinë, për doktrinën dhe për prestigjin e Kishës, mburrja e lidhur me administrimin e punëve praktike, tërheqja për dinamikën e vetë-ndihmës dhe të re realizimit vetëreferencial. Në këtë disa të krishterë shpenzojnë energjitë e tyre dhe kohën e tyre, në vend që të lejojnë të drejtohen

prej Shpirtit në rrugën e dashurisë, në vend që të kenë pasionin të komunikojnë bukurinë e gëzimin e Ungjillit dhe të kërkojnë të largët në turmat e pafundme të etura për Krishtin.[63]

58. Shumë herë, kundër shtytjes së Shpirtit, jeta e Kishës shndërrohet në një copë muzeu apo në një zotërim të pak vetëve. Kjo ndodh kur disa grupe të krishtera i japin rëndësi të tepruar zbatimit të disa normave, dokeve apo stileve të tyre. Në këtë mënyrë, shpesh Ungjilli kufizohet e ngushtohet, duke ia hequr atij thjeshtësinë dhe shijen e tij të mrekullueshme. Ndoshta është një formë e zbehtë e pelagianizmit, sepse duket se ia nënshton jetën e hirit disa strukturave njerëzore. Kjo ka lidhje me grupet, lëvizjet dhe bashkësitë, dhe është ajo që shpjegon faktin se përse shumë herë fillojnë me një jetë të gjallë në Shpirtin, por pastaj përfundojnë të fosilizuar... ose të prishur.

59. Pa e kuptuar, për faktin se mendojmë se gjithçka varet prej përpjekjes njerëzore të kanalizuar nëpërmjet normave e strukturave kishtarë, e ndërlikojmë Ungjillin dhe bëhemi skllavër të një skeme që i lë hirit pak mundësi për të vepruar. Shën Toma i Akuinit na kujtonte se urdhrat e shtuar Ungjillit nga ana e Kishës duhet të kërkojnë me maturi «për të mos e bërë të rëndë jetën e vëllezërve», sepse kështu besimi ynë do të shndërrohej në një skllavëri.[64]

#### *Përmbledhja e Ligjit*

60. Me qëllim që të shmangim këtë, është mirë të kujtojmë shpesh se ekziston një hierarki e virtyteve, që na fton të kërkojmë thelbësoren. Parësia u takon virtyteve teologale, që kanë Hyjin si objekt dhe motiv. Dhe në qendër gjendet dashuria. Shën Pali thotë se ajo që ka me të vërtetë rëndësi është «feja që vepron me dashuri» (*Gal* 5,6). Jemi të thirrur të kujdesemi fort për dashurinë: «Ai që e do tjetrin, e ka plotësuar Ligjin [...] Dashuria, pra, është zbatim i përsosur i Ligjit» (*Rom* 13,8.10). Sepse «i tërë Ligji përmbledhet në këtë urdhrë: "Duaje të afërmin tënd porsì vetveten!"» (*Gal* 5,14).

61. E thënë me fjalë të tjera: në mes të pyllit të dendur të urdhrave dhe normave, Jezusi hap një të çarë që lejon të dallohen dy fytyra, ajo e Atit dhe ajo e vëllait. Nuk na jep dy formula apo dy urdhra më shumë. Na jep dy fytyra, ose më mirë të themi, vetëm një fytyrë, atë të Hyjit që reflektohet në shumë vetë. Sepse në çdo vëlla, veçanërisht në më të voglin, të brishtin, të pambrojturin e nevojtarin, është e pranishme vetë shëmbëlltyra e Hyjit. Në të vërtetë, me mbetjet e këtij njerëzimi të dobët, në fund të kohëve, Zotëria do t'i japë formë veprës së tij të fundit të artit. Sepse «çfarë mbetet, çfarë ka vlerë në jetë, cilat pasuri nuk zhduken? Sigurisht dy: Zoti dhe i afërmi. Këto dy pasuri nuk zhduken!».[65]

62. Zoti e liroftë Kishën prej formave të reja të gnosticizmit dhe të pelagianizmit që e ndërlikojnë dhe e ndalojnë në ecjen e saj drejt shenjtërisë! Këto devijime shprehen në forma të ndryshme, sipas temperamentit dhe karakteristikave përkatëse. Prandaj e nxis secilin të pyesë veten dhe të shqyrtojë para Hyjit se në çfarë mënyre mund të bëhen të dukshme në jetën e tij.

## **KAPITULLI I TRETË**

### **NË DRITËN E MËSUESIT**

63. Mund të ketë shumë teori në lidhje me atë se çfarë është shenjtëria, shpjegime dhe dallime të shumta. Ky reflektim mund të jetë i dobishëm, por asgjë nuk na ndriçon më shumë sesa t'u kthehemi fjalëve të Jezusit dhe të kuptojmë mënyrën e tij të komunikimit të së vërtetës. Jezusi e ka shpjeguar me gjithë thjeshtësinë se çfarë do të thotë të jemi të shenjtë, dhe e ka bërë këtë kur na ka lënë Lumturitë (krh. *Mt* 5,3-12; *Lk* 6,20-23). Ato janë si karta e identitetit të të krishterit. Kështu, nëse dikush prej nesh bën pyetjen: "Si mund të arrij të jem një i krishterë i mirë?", përgjigjja është e thjeshtë: Është e nevojshme që, secili në mënyrën e vet, të bëjë atë që thotë Jezusi në fjalimin e Lumturive.[66] Në to përvijohet fytyra e Mësuesit, që jemi të thirrur ta bëjmë të tejdukët në jetën tonë të përditshme.

64. Fjala "i lumtur" apo "i lumë" bëhet sinonim i "shenjt", sepse shpreh se personi besnik ndaj Hyjit dhe që e jeton Fjalën e tij, arrin, në dhurimin e vetvetes, lumturinë e vërtetë.

### **Kundër rrymës**

65. Pavarësisht se fjalët e Jezusit mund të na duken poetike, ato shkojnë shumë kundër rrymës në krahasim me atë që është e zakonshme, me atë që bëhet në shoqëri; e, edhe pse ky mesazh i Jezusit na tërheq, në të vërtetë bota na çon drejt një tjetër stili jete. Lumturitë në asnjë mënyrë nuk janë diçka e lehtë apo sipërfaqësore; përkundrazi, ato mund t'i jetojmë vetëm nëse Shpirti Shenjt na pushton me gjithë fuqinë e vet dhe na liron prej dobësisë së egoizmit, të dembelisë, të krenarisë.

66. Le të kthehemi e ta dëgjojmë përsëri Jezusin, me gjithë dashurinë dhe respektin që meriton Mësuesi! Le t'i lejojmë atij të na lërë mbresë me fjalët e tij, të na nxisë, të na thërrasë në një ndryshim real jete! Përndryshe, shenjtëria do të jetë vetëm fjalë. Le të kujtojmë tani secilën lumturi në versionin e ungjillit të Mateut! (krh. 5,3-12).[67]

*«Lum skamnoret në shpirt sepse e tyre është Mbretëria e qiejve!».*

67. Ungjilli na fton ta njohim të vërtetën e zemrës sonë, për të parë se ku e vëmë sigurinë e jetës sonë. Normalisht i pasuri ndihet i sigurt me pasuritë e veta, dhe mendon se kur ato janë në rrezik, i gjithë kuptimi i jetës së tij mbi këtë tokë thërrmohet. Vetë Jezusi na e ka thënë këtë në shëmbëlltyrën e të pasurit të marrë, duke folur për atë njeri të sigurt në vetvete që, si një i marrë, nuk mendonte se mund të vdiste po atë ditë (krh. *Lk* 12,16-21).

68. Pasuritë nuk të sigurojnë asgjë. Madje, kur zemra ndihet e pasur, është aq e kënaqur me vetveten sa nuk ka hapësirë për Fjalën e Hyjit, për të dashur vëllezërit, as për të gëzuar gjërat më të rëndësishme të jetës. Kështu e privon veten prej të mirave më të mëdha. Prandaj Jezusi i quan të lumë skamnoret në shpirt, që kanë zemrën të varfër, në të cilën mund të hyjë Zoti me risinë e vet të vazhdueshme.

69. Kjo varfëri shpirti është shumë e lidhur me atë "mospërfillje të shenjtë" që propozonte shën Injaci i Lojolës, në të cilën arrijmë një liri të madhe të brendshme: «Për këtë arsye është e nevojshme të bëhemi mospërfillës ndaj të gjitha gjërave të krijuara (në gjithçka që i lejohet lirisë së vullnetit tonë të lirë dhe nuk i ndalohej), në mënyrë që të mos dëshirojmë nga ana jonë më shumë shëndetin sesa sëmundjen, më shumë pasurinë sesa varfërinë, më shumë nderin sesa çnderimin, më shumë jetën e gjatë sesa atë të shkurtër, e kështu në gjithçka tjetër».[68]

70. Luka nuk flet për një varfëri "shpirti" por që të jemi «skamnore» dhe kaq (krh. *Lk* 6,20), e kështu na fton edhe në një ekzistencë të rreptë dhe të zhveshur. Në këtë mënyrë, na thërret të bashkëndajmë jetën e më nevojtarëve, jetën që kanë bërë Apostujt dhe si

përfundim të bëhemi të ngjashëm me Jezusin, që «duke qenë i pasur, u bë për ju i varfër» (2 Kor 8,9).

Të jemi të varfër në zemër, kjo është shenjtëria.

«Lum ata që janë të butë sepse do ta trashëgojnë tokën!».

71. Është një shprehje e fortë, në këtë botë që qysh prej fillimit është një vend i armiqësisë, ku njerëzit grinden kudo, ku në të gjitha anët ka urrejtje, ku vazhdimisht i klasifikojmë të tjerët për idetë e tyre, zakonet e tyre, dhe madje edhe për mënyrën e tyre se si flasin e se si vishen. Pra, është mbretëria e krenarisë dhe e kotësisë, ku secili beson se ka të drejtë të ngrihet mbi të tjerët. Megjithatë, pavarësisht se duket e pamundur, Jezusi propozon një tjetër stil jete: butësinë. Është ajo që Ai e praktikonte me nxënësit e vet dhe që e sodisim në hyrjen e tij në Jerusalem: «Ja, Mbreti yt po vjen te ti, i butë, kalor mbi gomare e mbi gaç» (Mt 21,5; krh. Zak 9,9).

72. Ai tha: «Pranoni t'ju mësoj unë që jam zemërbutë e i përvuajtur! Kështu do të gjeni pushim për shpirtat tuaj» (Mt 11,29). Nëse jetojmë të trazuar, mujsharë përballë të tjerëve, përfundojmë të lodhur e të këputur. Por kur i shohim kufizimet e tyre dhe të metat e tyre me dashuri e butësi, pa u ndier superiorë, mund t'u japim atyre një dorë dhe të mos harxhojmë energji me ankesa të kota. Për shenjten Terezë të Lisiesë «dashuria e përsosur do të thotë t'i durojmë të metat e të tjerëve, të mos çuditemi absolutisht për dobësitë e tyre».[69]

73. Pali e përmend butësinë si fryt të Shpirtit Shenjt (krh. Gal 5,23). Propozon që, nëse ndonjëherë na shqetësojnë veprimet e këqija të vëllait, të afrohemi për t'i ndrequr, por «me shpirt butësie» (Gal 6,1), dhe kujton: «Ruaje veten që edhe ti të mos biesh në tundim» (ibid.). Edhe kur mbrojmë fenë tonë dhe bindjet tona, duhet ta bëjmë këtë me butësi (krh. 1 Pjt 3,16), e madje kundërshtarët duhet t'i trajtojmë me butësi (krh. 2 Tim 2,25). Në Kishë shumë herë kemi gabuar sepse nuk e kemi pranuar këtë thirrje të Fjalës hyjnore.

74. Butësia është një tjetër shprehje e varfërisë së brendshme, të atij që e vë besimin e vet vetëm në Hyjin. Faktikisht, në Bibël përdoret shpesh e njëjta fjalë *anaëim* për t'iu referuar të varfërve dhe të butëve. Dikush mund të kundërshtojë: "Nëse jam tepër i butë, do të mendojnë se jam i marrë, se jam budalla apo i dobët". Mund të jetë kështu, por le t'i lëmë të tjerët ta mendojnë. Është më mirë të jemi gjithmonë të butë, dhe do të realizohen aspiratat tona më të mëdha: të butët «do ta trashëgojnë tokën», pra, do t'i shohin të plotësuara në jetën e tyre premtimet e Hyjit. Sepse të butët, përtej asaj që thonë rrethanat, shpresojnë në Zotin dhe ata që shpresojnë në Zotin do ta trashëgojnë tokën dhe do të gëzojnë një paqe të madhe (krh. Ps 37,9.11). Në të njëjtën kohë, Zoti ka besim në ta: «Mbi këtë e ngul vështrimin tim: mbi varfanjakun e mbi zemërplasin që dridhet prej fjalëve të mia» (Is 66,2).

Të reagojmë me butësi të përvuajtur, kjo është shenjtëria.

«Lum ata që qajnë sepse do të ngushëllohen!».

75. Bota na propozon të kundërtën: zbavitjen, qejfin, shpërqendrimet, dëfrimin, dhe na thotë se kjo është ajo që e bën të mirë jetën. Njeriu i botës shpërfill, shikon në anën tjetër kur ka probleme sëmundjeje apo dhimbjeje në familje apo përreth tij. Bota nuk dëshiron të qajë: parapëlqen t'i shpërfillë situatat e dhimbshme, t'i mbulojë ato, t'i fshehë. Shpenzohen

shumë energji për t'iu shmangur situatave në të cilat bëhet e pranishme vuajtja, duke besuar se është e mundur të fshihet realiteti, ku kurrë, kurrë nuk mund të mungojë kryqi.

76. Personi që i sheh gjërat ashtu siç janë realisht, lejon të shporohet prej dhimbjes dhe qan në zemrën e vet, është i aftë të arrijë thellësitë e jetës dhe të jetë me të vërtetë i lumtur.[70] Ai person është i ngushëlluar, por me ngushëllimin e Jezusit dhe jo me atë të botës. Kështu mund të ketë guximin të bashkëndajë vuajtjen e të tjerëve dhe nuk i shmang më situatat e dhimbshme. Në këtë mënyrë zbulon se jeta ka kuptim kur ndihmon një tjetër në dhimbjen e tij, kur kupton ankthin e tjetrit, kur i lehtëson të tjerët. Ky person ndien se tjetri është mish i mishit të vet, nuk druan të afrohet aq sa të prekë plagën e tij, ka dhembshuri aq sa të përjetojë se largësitë zhduken. Kështu është e mundur ta pranojmë atë nxitje të shën Palit: «Qani me ata që qajnë!» (Rom 12,15).

Të dimë të qajmë me të tjerët, kjo është shenjtëria.

*«Lum ata që kanë uri e etje për drejtësi sepse do të ngihen!».*

77. «Uri e etje» janë shprehje shumë të forta, sepse u përgjigjen nevojave parësore dhe janë të lidhura me instinktin e mbijetesës. Ka persona që me intensitet e dëshirojnë drejtësinë dhe e kërkojnë atë me një dëshirë shumë të fortë. Jezusi thotë se ata do të ngihen, sepse herët a vonë drejtësia mbërrin, dhe ne mund të bashkëpunojmë që kjo të jetë e mundur, edhe pse jo gjithmonë i shohim rezultatet e këtij angazhimit tonë.

78. Por drejtësia që propozon Jezusi nuk është si ajo që kërkon bota, shumë herë e njollosur prej interesave mesquine, e manipuluar nga një anë apo nga ana tjetër. Realiteti na tregon se sa e lehtë është të hyjmë në rrethet e korrupsionit, të bëjmë pjesë në atë politikë të përditshme të "jap që të më japin", në të cilën gjithçka është tregti. Dhe sa njerëz vuajnë prej padrejtësive, sa vetë rrinë e shohin të pafuqishëm se si të tjerët zënë vendin e njëri-tjetrit për të ndarë mes tyre tortën e jetës. Disa heqin dorë nga lufta për drejtësinë e vërtetë dhe zgjedhin të ngjiten në karrocën e fitimtarit. Kjo nuk ka aspak të bëjë me urinë dhe etjen për drejtësi të cilën e lëvdon Jezusi.

79. Kjo drejtësi fillon të realizohet në jetën e secilit atëherë kur ai është i drejtë në vendimet e veta, dhe shprehet pastaj në kërkimin e drejtësisë për të varfrit dhe të dobëtit. Sigurisht, fjala "drejtësi" mund të jetë sinonim i besnikërisë ndaj vullnetit të Hyjit me gjithë jetën tonë, por nëse i japim një kuptim shumë të përgjithshëm atëherë harrojmë se dëftohet veçanërisht në drejtësinë me të pambrojturit: «Kërkojeni drejtësinë, ndihmoni të shtypurit, jepini të drejtën bonjakut, mbrojeni të vejen!» (Is 1,17).

Të kërkojmë drejtësinë me uri e etje, kjo është shenjtëria.

*«Lum të mëshirshmit sepse do të gjejnë mëshirë!».*

80. Mëshira ka dy aspekte: do të thotë të japim, të ndihmojmë, t'iu shërbejmë të tjerëve si dhe të falim, të kuptojmë. Mateu e përmbledh këtë në një rregull të artë: «Gjithçka dëshironi t'ju bëjnë juve njerëzit, bëjuani edhe ju atyre!» (7,12). Katekizmi na kujton se ky ligj duhet të zbatohet «në çdo rast», [71] në mënyrë të veçantë kur dikush «nganjëherë i duhet të përballojë situata të vështira që e bëjnë të pasigurt gjykimin moral». [72]

81. Të japim dhe të falim do të thotë të përpiqemi të riprodhojmë në jetën tonë një refleks të vogël të përsosurisë së Hyjit, që dhuron dhe fal në mënyrë të begatshme. Për këtë arsye në ungjillin e Lukës nuk gjejmë «Jini të përkryer!» (Mt 5,48), por «Bëhuni edhe ju të

mëshirshëm sikurse edhe Ati juaj është i mëshirshëm! Mos gjykoni dhe nuk do të gjykoheni! Mos dënoni e nuk do të dënoheni! Falni e do të gjeni falje! Jepni e do t'ju jepet!» (6,36-38). E më pas Luka shton diçka që nuk duhet ta lëmë pas dore: «Me atë masë që të matni, do t'ju matet edhe juve në kthim» (6,38). Masa që përdorim për të kuptuar dhe për të falur do të përdoret për të na falur ne. Masa që përdorim për të dhënë, do të përdoret për të na shpërblyer ne në qiell. Nuk na leverdis ta harrojmë këtë.

82. Jezusi nuk thotë "Lum ata që programojnë hakmarrje!", por i quan të lumë ata që falin dhe e bëjnë këtë «shtatëdhjetë herë shtatë» (Mt 18,22). Duhet të mendojmë se të gjithë ne jemi një ushtri të falurish. Të gjithë ne jemi shikuar me dhembshuri hyjnore. Nëse i afrohem i sinqerisht Zotit dhe e mprehim dëgjimin, ka të ngjarë se do ta dëgjojmë ndonjëherë këtë qortim: «A nuk u desh që edhe ti të kishe mëshirë ndaj shokut tënd, sikurse edhe unë pata mëshirë ndaj teje?» (Mt 18,33).

Të shikojmë dhe të veprojme me mëshirë, kjo është shenjtëria.

*«Lum ata që janë të pastër në zemër sepse do ta shohin Hyjin!».*

83. Kjo lumturi e ka fjalën për ata që kanë një zemër të thjeshtë, të pastër, pa ndyrësi, sepse një zemër që di të dojë nuk lejon të hyjë në jetën e vet asnjë gjë që e kërcënon atë dashuri, që e dobëson ose që e vë në rrezik. Në Bibël, zemra janë qëllimet tona të vërteta, ajo që realisht kërkojmë dhe dëshirojmë, përtej asaj që shfaqim përjashta: «Njeriu sheh çka duket përjashta, kurse Zoti vëren zemrën» (1 Sam 16,7). Ai kërkon të na flasë në zemër (krh. Oz 2,16) dhe aty dëshiron ta shkruajë Ligjin e vet (krh. Jer 31,33). Si përfundim, dëshiron të na japë një zemër të re (krh. Ez 36,26).

84. «Me më të madhin kujdes ruaje zemrën tënde!» (Fu 4,23). Asgjë e njollosur prej shtirësisë nuk ka vlerë reale për Zotin. Ai «ikën nga shtiracaku, largohet nga mendimet e marra» (Urt 1,5). Ati, që «sheh në fshehtësi» (Mt 6,6), e njeh atë që nuk është e pastër, domethënë atë që nuk është e sinqertë, por vetëm dukje e jashtme, ashtu sikurse edhe Biri e di «çka njeriu ndryn përbrenda» (Gjn 2,25).

85. Është e vërtetë se nuk ka dashuri pa vepra dashurie, por kjo lumturi na kujton se Zoti pret një përkushtim ndaj vëllait që buron prej zemrës, sepse «Po ta ndaja lëmoshë mbarë pasurinë time dhe po ta jepja trupin tim të digjej, por, po të më mungonte dashuria, nuk do të më vlente asgjë» (1 Kor 13,3). Në ungjillin e Mateut shohim edhe se ajo që vjen prej zemrës është ajo që e bën njeriun të papastër (krh. 15,18), sepse prej aty dalin vrasjet, vjedhjet, dëshmitë e rreme, e kështu me radhë (krh. 15,19). Në qëllimet e zemrës e kanë zanafillën dëshirat dhe vendimet më të thella që realisht na nxisin.

86. Kur zemra do Hyjin dhe të afërmin (krh. Mt 22,36-40), kur ky është qëllimi i saj i vëretë dhe jo fjalë të zbrazëta, atëherë ajo zemër është e pastër dhe mund ta shohë Hyjin. Shën Pali, në himnin e vet të dashurisë, kujton se «tani shikojmë si në pasqyrë e në mënyrë të errët» (1 Kor 13,12), por në masën në të cilën mbretëron me të vërtetë dashuria, do të bëhemi të aftë të shohim «faqe-faqas» (ibid.). Jezusi premton se ata që kanë një zemër të pastër «do ta shohin Hyjin».

Ta mbajmë zemrën të pastër nga gjithçka që e ndyn dashurinë, kjo është shenjtëria.

*«Lum pajtuesit sepse do të quhen bijtë e Hyjit!».*



87. Kjo lumturi na bën të mendojmë për situatat e shumta të luftës që përsëriten. Për ne është shumë e zakonshme të jemi shkak konfliktesh ose të paktën moskuptimesh. Për shembull, kur dëgjoj diçka për dikë dhe shkoj te një tjetër e ia them; e ndoshta bëj një version të dytë pak më të gjerë dhe e përhap. E nëse arrij të bëj më shumë dëm, duket se i jap vetes më shumë kënaqësi. Bota e thashethemeve, e përbërë prej njerëzish që angazhohen për të kritikuar e për të shkatërruar, nuk ndërton paqen. Këta njerëz janë armiq të paqes dhe në asnjë mënyrë të lumë.[73]

88. Pajturesit janë burim i paqes, ndërtojnë paqe dhe miqësi shoqërore. Atyre që angazhohen për të mbjellë paqe kudo, Jezusi u bën një premtim të mrekullueshëm: «Do të quhen bijtë e Hyjit» (Mt 5,9). Ai u kërkonte nxënësve që kur të arrinin në një shtëpi të thoshin: «Paqja me këtë shtëpi!» (Lk 10,5). Fjala e Hyjit e nxit çdo besimtar që të kërkojë paqen së bashku me të tjerët (krh. 2 Tim 2,22), sepse «fryti i drejtësisë mbillet në paqe për ata që punojnë për paqe» (Jak 3,18). Dhe nëse në ndonjë rast në bashkësinë tonë kemi dyshime për atë se çfarë duhet bërë, «të mundohemi të bëjmë të përparojë paqja» (Rom 14,19), sepse bashkimi qëndron më lart se konflikti.[74]

89. Nuk është e lehtë ta ndërtojmë këtë paqe ungjillore që nuk përjashton askënd, por që i integron edhe ata që janë pak të çuditshëm, personat e vështirë dhe të ndërlikuar, ata që kërkojnë vëmendje, ata që janë të ndryshëm, ata që janë goditur shumë prej jetës, ata që kanë interesa të tjera. Është e vështirë dhe kërkon një hapje të madhe të mendjes e të zemrës, sepse nuk bëhet fjalë për «një miradije në tavolinë apo për një paqe kalimtare për një pakicë të lumtur»[75], as për një projekt «të pak vetëve të drejtuar pak vetëve».[76] As nuk kërkon të shpërfillen apo të fshehen konfliktet, por «të pranohet që të durohet konflikti, të zgjidhet e të shndërrohet në një hallkë lidhjeje të një procesi të ri».[77] Bëhet fjalë që të jemi artizanë të paqes, sepse ndërtimi i paqes është një art që kërkon kthjelltësi, krijimtari, ndjeshmëri dhe shkathtësi.

Të mbjellim paqen përreth nesh, kjo është shenjtëria.

*«Lum ata që salvohen për drejtësinë, sepse e tyre është Mbretëria e qiejve!».*

90. Vetë Jezusi thekson se kjo ecje shkon kundër rrymës deri në atë pikë sa na bën të bëhemi persona që me jetën e vet vënë në diskutim shoqërinë, persona që japin bezdi. Jezusi kujton se sa njerëz përndiqen dhe janë përndjekur thjesht sepse kanë luftuar për drejtësinë, sepse i kanë jetuar angazhimet e tyre me Hyjin dhe me të tjerët. Nëse nuk duam të biem në një mediokritet të errët, të mos pretendojmë një jetë të rehatshme, sepse «kush do ta ruajë jetën e vet, do ta bjerrë» (Mt 16,25).

91. Nuk mund të presim që, për ta jetuar Ungjillin, gjithçka përreth nesh të jetë e volitshme, sepse shumë herë ambiciet e pushtetit dhe interesat e botës luajnë kundër nesh. Shën Gjon Pali II thoshte se «është e tjetërsuar shoqëria që, në format e veta të organizimit shoqëror, të prodhimit e të konsumit, e bën më të vështirë realizimin [e] dhurimit [të vetvetes] dhe ndërtimin [e] solidaritetit ndërnjerëzor»[78]. Në një shoqëri të tillë të tjetërsuar, të bllokuar në një kurth politik, mediatik, ekonomik, kulturor dhe madje edhe fetar që e pengon zhvillimin e njëmendtë njerëzor e shoqëror, t'i jetojmë Lumturitë bëhet e vështirë dhe mund të jetë madje edhe një gjë që shihet shtrembër, që vihet në dyshim dhe përqeshet.

92. Kryqi, sidomos lodhjet dhe mundimet që durojmë për të jetuar urdhrin e dashurisë dhe ecjen e drejtësisë, është burim i pjekurimit dhe i shenjtërimit. Le të kujtojmë se, kur Besëlidhja e Re flet për vuajtjet që duhet të durojmë për Ungjillin, e ka fjalën saktësisht për përndjekjet (krh. Vap 5,41; Fil 1,29; Kol 1,24; 2 Tim 1,12; 1 Pjt 2,20; 4,14-16; Zb 2,10).

93. Por flasim për përndjekjet e pashmangshme, jo për ato që mund t'i shkaktojmë vetvetes me një mënyrë të gabuar të trajtimit të të tjerëve. Shenjti nuk është një person i çuditshëm, i shkëputur, që bëhet i padurueshëm prej mendjemadhësisë së tij, negativitetit të tij dhe hatërmbetjeve të tij. Nuk ishin kështu Apostujt e Krishtit. Libri i Veprave të Apostujve tregon me këmbëngulje se ata gëzonin simpatinë «e mbarë popullit» (2,47; krh. 4,21.33; 5,13), ndërsa disa autoritete i kërkonin dhe i përndiqnin (krh. 4,1-3; 5,17-18).

94. Përndjekjet nuk janë një realitet i së kaluarës, sepse edhe sot i vuajmë ato, qoftë në mënyrë të përgjashme, sikurse shumë martirë bashkëkohorë, qoftë në një mënyrë më të hollë, nëpërmjet shpifjeve e pavërtetësive. Jezusi thotë se do të jemi të lumë kur «për shkakun tim, t'i thonë të gjitha të zezat kundër jush, por në rrenë» (Mt 5,11). Herë të tjera bëhet fjalë për skema që përpiqen ta përçudnojnë fenë tonë dhe të na bëjnë të dukemi persona qesharakë.

Të pranojmë çdo ditë udhën e Ungjillit pavarësisht se na shkakton probleme, kjo është shenjtëria.

### **Rregulla e madhe e sjelljes**

95. Në kapitullin 25 të ungjillit të Mateut (rr. 31-46), Jezusi ndalet përsëri në njërën prej këtyre lumturive, në atë që i shpall të lumë të mëshirshmit. Nëse kërkojmë atë shenjtëri që është e pëlqyeshme para syve të Hyjit, në këtë tekst gjejmë pikërisht një rregull sjelljeje në bazë të së cilës do të gjykohemi: «Pata uri e më dhatë të ha, pata etje e më dhatë të pi, isha shtegtar e më përbujtët, isha i zhveshur e më veshët, i sëmurë e erdhët të më shihni, isha në burg e erdhët tek unë» (25,35-36).

#### *Për besnikëri ndaj Mësuesit*

96. Të jesh shenjt nuk do të thotë, pra, të të shkëlqejnë sytë në një ekstazë të supozuar. Gjon Pali II thoshte se «nëse kemi rinisur me të vërtetë prej soditjes së Krishtit, duhet të dimë ta dallojmë atë sidomos në fytyrën e atyre me të cilët ai vetë ka dashur të identifikohet».[79] Teksti i *Mateut* 25,35-36 «nuk është një ftesë e thjeshtë në dashurinë e krishterë: është një faqe kristologjike, që projekton një rreze drite mbi misterin e Krishtit».[80] Në këtë thirrje për ta njohur atë në të varfrit dhe në ata që vuajnë zbulohet vetë zemra e Krishtit, ndjenjat e tij dhe zgjedhjet e tij më të thella, **me të cilat çdo shenjt përpiqet të përputhet.**

97. Para forcës së këtyre kërkesave të Jezusit është detyrë e imja t'i lus të krishterët që t'i pranojnë e t'i mirëpresin me hapje të sinqertë, «sine glossa», domethënë pa komente, pa stërhollime dhe shfajësime që ua heqin atyre forcën. Zoti na e ka bërë krejt të qartë se shenjtëria nuk mund të kuptohet dhe as të jetohet pavarësisht prej këtyre kërkesave të tij, sepse mëshira është «zemra e gjallë e Ungjillit».[81]

98. Kur takoj një person që fle në mot të keq, në një natë të ftohtë, mund të ndiej se ky njeri i veshur keq është një e papritur që më pengon, një kriminel dembel, një pengesë në rrugën time, një thumb i bezdisshëm për ndërgjegjen time, një problem që duhet ta zgjidhin politikanët, dhe ndoshta edhe një pisllek që ndyen hapësirën publike. Ose mund të reagoj duke nisur prej fesë e prej dashurisë dhe të shoh në të një qenie njerëzore me të njëjtin dinjitet që kam unë, një krijesë pafundësisht të dashur prej Atit, një shëmbëlltë të Hyjit, një vëlla të shëlbuar prej Krishtit. Kjo do të thotë të jemi të krishterë! Apo, mos ndoshta shenjtëria mund të kuptohet pavarësisht prej kësaj njohjeje të gjallë të dinjitetit të çdo qenieje njerëzore?[82]

99. Kjo sjell për të krishterët një pakënaqësi të shëndoshë dhe të përhershme. Edhe pse qoftë edhe lehtësimi i një personi të vetëm do t'i arsyetonte të gjitha përpjekjet tona, kjo nuk na mjafton. Ipeshkvijtë e Kanadasë e kanë pohuar qartë këtë duke treguar se, në mësimet biblike në lidhje me Jubileun, për shembull, nuk bëhet fjalë vetëm për të realizuar disa vepra të mira, por për të kërkuar një ndryshim shoqëror: «Që edhe brezat e ardhshëm të liroheshin, është e qartë se objektivi duhej të ishte rekuperimi i sistemeve shoqërore dhe ekonomike të drejta në mënyrë që të mos kishte më përjashtim».[83]

#### *Ideologjitë që e sakatojnë zemrën e Ungjillit*

100. Mjerisht nganjëherë ideologjitë na çojnë në dy gabime të dëmshme. Nga njëra anë, ai i të krishterëve që i ndajnë këto kërkesa të Ungjillit prej marrëdhënies së tyre personale me Zotin, prej bashkimit të brendshëm me Të, prej hirit. Kështu krishterimi shndërrohet në njëfarë OJQ-je, duke e privuar atë prej përshtypjes së ndritshme që e kanë jetuar dhe shfaqur aq mirë shën Françesku i Asizit, shën Vinçenc de Paoli, shenjtja Terezë e Kalkutës dhe shumë të tjerë. Këtyre shenjtërve as lutja, as dashuria për Hyjin, as leximi i Ungjillit nuk ia pakësuan pasionin dhe efikasitetin e përkushtimit të tyre ndaj të afërmit, por krejt e kundërta.

101. I dëmshëm dhe ideologjik është edhe gabimi i atyre që jetojnë duke mos pasur besim në angazhimin shoqëror të të tjerëve, duke e konsideruar atë si diçka sipërfaqësore, punë të botë, të shekullarizuar, imanentiste, komuniste, populiste. Ose e relativizojnë sikur të ketë gjëra të tjera më të rëndësishme ose sikur të ketë lidhje vetëm me një etikë të caktuar apo me një arsye që ata e mbrojnë. Mbrojtja e të pafajshmit që nuk ka lindur, për shembull, duhet të jetë e qartë, e ngultë dhe e apasionuar, sepse aty është në lojë dinjiteti i jetës njerëzore, gjithmonë e shenjtë, dhe e kërkon këtë dashuria për çdo person pavarësisht prej zhvillimit të tij. Por po ashtu e shenjtë është jeta e të varfërve që tashmë kanë lindur, që vuajnë në mjerim, në braktisje, në përjashtim, në trafikimin e personave, në eutanazinë e fshehur të të sëmurëve dhe të të moshuarve të privuar prej kujdesit, në format e reja të skllavërisë, dhe në çdo formë skartimi.[84] Nuk mund t'i vëmë vetes si qëllim një ideal shenjtërie që e shpërfill padrejtësinë e kësaj bote, ku disa festojnë, shpenzojnë hareshëm dhe e kufizojnë jetën e tyre në risitë e konsumit, ndërsa të tjerët shikojnë vetëm nga jashtë dhe ndërkaq jeta e tyre kalon e mbaron mjerueshëm.

102. Shpesh dëgjojmë të thuhet se, përballë relativizmit dhe kufizimeve të botës aktuale, do të ishte një temë dytësore, për shembull, situata e migrantëve. Disa katolikë pohojnë se është një temë dytësore në krahasim me temat "serioze" të bioetikës. Që gjëra të tilla t'i thotë një politikan i shqetësuar për sukseset e tij, kjo mund të kuptohet, por jo një i krishterë, të cilit i ka hije vetëm qëndrimi i vendosjes së vetvetes në vendin e atij vëllai që rrezikon jetën për t'u dhënë një të ardhme bijve të vet. A mund të pranojmë se është pikërisht ajo që na kërkon Jezusi kur na thotë se pranojmë Atë vetë në çdo të huaj (krh. Mt 25,35)? Shën Benedikti e kishte pranuar pa rezerva dhe, edhe pse kjo mund ta "ndërlikonte" jetën e murgjërve, vendosi që të gjithë mysafirët që do të paraqiteshin në manastir të pranoheshin «si Krishti»,[85] duke e shprehur këtë madje edhe me gjeste adhurimi,[86] dhe që shtegtarët e varfër të trajtoheshin «me kujdesin e vëmendjen më të madhe».[87]

103. Diçka të ngjashme paraqet edhe Besëlidhja e Vjetër kur thotë: «Mos e shfrytëzo as mos e shtyp të huajin, sepse edhe ju qetë të huaj në dheun e Egjiptit!» (Da/22,20). «Nëse jeton me ty i huaji në tokën tuaj, mos e shtypni; por le të jetë ndër ju si vendas dhe duaje si vetveten: edhe ju keni qenë të huaj në dheun e Egjiptit!» (Lev 19,33-34). Prandaj, nuk bëhet fjalë për sajimin e një Pape apo për një delir kalimtar. Edhe ne, në kontekstin aktual,

jemi të thirrur të jetojmë ecjen e ndriçimit shpirtëror që na paraqiste Isaia profet kur pyeste se çfarë është e pëlqyeshme për Hyjin: «A jo ta ndash bukën tënde me të uriturin, t'i shtiesh në shtëpinë tënde skamnorët e të pastrehët? Kur ta shohësh të zhveshurin, vishe dhe mos e përbuz farefisën tënd! Atëherë do të zbardhë porsia agimi drita jote» (58,7-8).

### *Kulti që i pëlqen më shumë Atij*

104. Mund të mendojmë se i japim lavdi Hyjit vetëm me kultin dhe lutjen, ose vetëm duke zbatuar disa norma etike – është e vërtetë se parësia i takon marrëdhënies me Hyjin –, dhe harrojmë se kriteri për ta vlerësuar jetën tonë është para së gjithash ajo që u kemi bërë të tjerëve. Lutja është e çmueshme nëse ushqen një dhurim të përditshëm dashurie. Kulti ynë është i pëlqyeshëm për Hyjin kur aty sjellim qëllimet për të jetuar me zemërgjerësi dhe kur lejojmë që dhurata e Hyjit, që marrim në të, të dëftohet në përkushtimin ndaj vëllezërve.

105. Për të njëjtën arsye, mënyra më e mirë për të kuptuar nëse ecja jonë e lutjes është e njëmendtë do të jetë të vërejmë se në çfarë mase jeta jonë shndërrohet në dritën e mëshirës. Sepse «mëshira nuk është vetëm të vepruarit e Atit, por bëhet kriteri për të kuptuar se kush janë bijtë e tij të vërtetë».[88] Ajo është «arkitrua që mban jetën e Kishës».[89] Dëshiroj të theksoj edhe një herë se, megjithëse mëshira nuk përjashton drejtësinë dhe të vërtetën, «para së gjithash duhet të themi se mëshira është plotësia e drejtësisë dhe dëftimi më i ndritshëm i së vërtetës së Hyjit».[90] Ajo «është çelësi i qiellit».[91]

106. Nuk mund të lë pa përmendur atë pikëpyetje që i parashtronte vetes shën Toma i Akuinit kur pyeste se cilat janë veprimet tona më të mëdha, cilat janë veprat e jashtme që e dëftojnë më mirë dashurinë tonë për Hyjin. Ai u përgjigj pa dyshim se janë veprat e mëshirshme ndaj të afërmit,[92] më shumë se sa aktet e kultit: «Ne nuk e ushtrojmë kultin ndaj Hyjit me fli dhe me kushte të jashtme në dobi të tij, por në dobinë tonë dhe të të afërmit: në të vërtetë Ai nuk ka nevojë për flitë tona, por do që ato t'i kushtohen për devocionin tonë dhe në dobi të të afërmit. Prandaj mëshira me të cilën i shkohet në ndihmë mjerimit të tjetrit është një fli më e pëlqyeshme për Të, pasi ajo siguron më nga afër të mirën e të afërmit».[93]

107. Ai që me të vërtetë dëshiron t'i japë lavdi Hyjit me jetën e vet, ai që realisht dëshiron të shenjtërohet në mënyrë që ekzistenca e tij t'i japë lavdi Shenjtit, është i thirrur të mundohet, të shpenzohet dhe të lodhet duke u përpjekur të jetojë veprat e mëshirshme. Është ajo gjë të cilën e kishte kuptuar shumë mirë shenjtja Terezë e Kalkutës: «Po, kam shumë dobësi njerëzore, shumë mjerime njerëzore. [...] Por Ai përulet dhe na përdor ne, ty dhe mua, për të qenë dashuria e tij dhe dhembshuria e tij në botë, pavarësisht prej mëkateve tona, pavarësisht prej mjerimeve tona dhe të metave tona. Ai varet prej nesh për ta dashur botën dhe për t'i treguar sesa shumë e do. Nëse merremi shumë me vetveten, nuk do të na mbetet kohë për të tjerët».[94]

108. Konsumizmi hedonist mund të na bëjë një lojë të keqe, sepse me obsesionin për t'u zbavitur përfundojmë të jemi tepër të përqendruar në vetvete, në të drejtat tona dhe në ngulmimin për të pasur kohë të lirë që ta gëzojmë jetën. Do të jetë e vështirë që të angazhohemi dhe të kushtojmë energji për t'i dhënë ndihmë atij që është keq nëse nuk kultivojmë njëfarë përkoreje, nëse nuk luftojmë kundër këtyre etheve që na imponon shoqëria e konsumit për të na shitur gjëra, dhe që, në fund, na shndërron në të pakënaqur të shkretë që duan të kenë gjithçka dhe të provojnë gjithçka. Edhe konsumi i informacionit sipërfaqësor dhe format e komunikimit të shpejtë e virtual mund të jenë një faktor i trulllosjes që merr me vete gjithë kohën tonë dhe na largon prej trupit të vuajtur të

vëllezërve. Në mes të kësaj vorbulle aktuale, Ungjilli jehon përsëri për të na ofruar një jetë të ndryshme, më të shëndoshë dhe më të lumtur.

\* \* \*

109. Forca e dëshmisë së shenjtërve gjendet në të jetuarit e Lumturive dhe të rregullës së sjelljes së gjyqit të fundit. Janë pak fjalë, të thjeshta, por praktike dhe të vlefshme për të gjithë, sepse krishterimi është bërë sidomos për t'u praktikuar, dhe nëse është edhe objekt i reflektimit, kjo ka vlerë vetëm kur na ndihmon ta jetojmë Ungjillin në jetën e përditshme. Ju porosis fort që t'i rilexoni shpesh këto tekste të mëdha biblike, t'i kujtoni, të luteni me ta dhe të përpiqeni t'i mishëroni! Do të na bëjnë mirë, do të na bëjnë përnjëmend të lumtur.

## KAPITULLI I KATËRT

### DISA KARAKTERISTIKA TË SHENJTËRISË NË BOTËN AKTUALE

110. Brenda kuadrit të madh të shenjtërisë që na paraqesin Lumturitë dhe *Mateu 25,31-46*, do të doja të shqyrtonim disa karakteristika apo shprehje shpirtërore që, sipas mendimit tim, janë të domosdoshme për ta kuptuar stilin e jetës në të cilin na thërret Zoti. Nuk do të ndalem për të shpjeguar mjetet e shenjtërimit që i njohim: metodat e ndryshme të lutjes, sakramentet e çmueshme të Eukaristisë dhe të Pajtimit, kushtimi i flive, format e ndryshme të devotshmërisë, drejtimi shpirtëror, dhe shumë të tjera. Do t'u referohem vetëm disa aspekteve të thirrjes në shenjtëri që shpresoj të jehojnë në mënyrë të veçantë.

111. Këto karakteristika që dua t'i vë në dukje nuk janë të gjitha ato që mund të përbëjnë një model shenjtërie, por janë pesë dëftime të mëdha të dashurisë për Hyjin dhe për të afërmin që i konsideroj veçanërisht të rëndësishme për arsye të disa rreziqeve dhe kufizimeve të kulturës së sotme. Në të shfaqen: ankthi nervoz dhe i dhunshëm që na shkapërdan e na dobëson; negativiteti dhe trishtimi; përtesa e rehatshme, konsumiste dhe egoiste; individualizmi, si dhe shumë forma të përshpirtërisë së rremë pa takim me Hyjin që mbizotërojnë në tregun fetar aktual.

#### **Durimi dhe butësia**

112. E para ndër këto karakteristika të mëdha është të rrimë të përqendruar, të fortë në Hyjin që do dhe përkrah. Duke nisur prej kësaj vendosmërie të brendshme është e mundshme të durojmë, t'u bëjmë ballë kundërshtive, përvojave negative të jetës, si edhe sulmeve të të tjerëve, pabesnikërive të tyre dhe të metave të tyre: «Nëse Hyji na përkrah, kush do të jetë kundër nesh?» (*Rom 8,31*). Ky është burimi i paqes që shprehet në qëndrimet e një shenjtërie. Në bazë të kësaj qëndrueshmërie të brendshme, dëshmia e shenjtërisë, në botën tonë të përshpejtuar, të ndryshueshme dhe agresive, përbëhet prej durimit dhe qëndresës në të mirën. Është besnikëria e dashurisë, sepse ai që mbështetet në Hyjin (*pistis*) mundet edhe të jetë besnik para vëllezërve (*pistós*), nuk i braktis ata në momentet e vështira, nuk lejon të bëhet pre e ankthit dhe mbetet pranë të tjerëve edhe kur kjo gjë nuk i jep kënaqësi të menjëhershme.

113. Shën Pali i ftonte të krishterët e Romës që të mos ia kthejnë askujt «të keqen me të keqe» (*Rom 12,17*), të mos kërkojnë të bëjnë drejtësi vetë (krh. rr. 19) dhe të mos lejojnë të munden prej së keqes, por të ngadhënjejnë mbi të keqen me vepra të mira (krh. rr. 21). Ky qëndrim nuk është shenjë e dobësisë por e forcës së vërtetë, sepse vetë Hyji «është i durueshëm e i madhërueshëm në fuqi» (*Nah 1,3*). Fjala e Hyjit na paralajmëron: «Le të flaket larg jush çdo pikëllim, zemërim, hidhërim, britmë, sharje me çdo lloj ligësie!» (*Ef 4,31*).

114. Është e nevojshme të luftojmë dhe të ruhem i prerë prej prirjeve tona agresive dhe egocentrike për të mos lejuar që ato të lëshojnë rrënjë: «Po u zemëruat? Mos mëkaton! Dielli të mos perëndojë mbi hidhërimin tuaj!» (*Ef 4,26*). Kur ka rrethana që na rëndojnë, mund të përdorim gjithmonë spirancën e lutjes, që na bën të qëndrojmë përsëri në duart e Hyjit dhe afër burimit të paqes: «Për asgjë mos u shqetësoni, por gjithçka – me lutje dhe me lutje të përcjella me falënderim – paraqitjani Hyjit nevojat tuaja! Dhe paqja e Hyjit, që është më e vlefshme se mund ta mendojmë, do t'i ruajë zemrat tuaja» (*Fil 4,6-7*).

115. Edhe të krishterët mund të marrin pjesë në rrjete të dhunës verbale nëpërmjet internetit dhe fushave apo hapësirave të ndryshme të shkëmbimit dixhital. Edhe në *mediat* katolike mund të kalohen kufijtë, të tolerohen shpifja dhe përgojimi, dhe duket sikur përjashtohet çdo etikë dhe çdo respekt për emrin e mirë të tjetrit. Kështu verifikohet një dualizëm i rrezikshëm, sepse në këto rrjete thuhet gjëra që nuk do të ishin të tolerueshme në jetën publike, dhe bëhen përpjekje për të kompensuar pakënaqësitë vetjake duke shkarkuar me zemërim dëshirat për hakmarrje. Është domethënë fakti se nganjëherë, duke pretenduar që të mbrohen urdhërime të tjera, kalohet krejtësisht mbi urdhrin e tetë: «Mos bëj dëshmi në rrenë!», dhe shkatërrohet pa mëshirë imazhi i tjetrit. Aty dëftohet pa asnjë kontroll se gjuha është «bota e së keqes» dhe «e ndezur nga ferri, e bën shkrumb të tërë jetën» (*Jak 3,6*).

116. Vendosmëria e brendshme, që është vepër e hirit, na ruan që të mos lejojmë të na tërheqë me vete dhuna e cila pushton jetën shoqërore, sepse hiri e zhdurkotësinë dhe e bën të mundur butësinë e zemrës. Shenjti nuk i harxhon energjitë e veta duke u ankuar për gabimet e të tjerëve, është i aftë të heshtë para të metave të vëllezërve dhe e shmang dhunën verbale që shkatërron e keqtrajton, sepse nuk e konsideron veten të denjë të jetë i ashpër me të tjerët, por i konsideron ata «më të mëdhenj se veten» (krh. *Fil 2,3*).

117. Nuk na bën mirë të shohim nga lart poshtë, të marrim rolin e gjykatësve të pamëshirshëm, t'i konsiderojmë të tjerët si të padenjë dhe të pretendojmë vazhdimisht që të japim mësim. Kjo është një formë e hollë dhune.<sup>[95]</sup> Shën Gjoni i Kryqit propozonte një gjë tjetër: «Ji më shumë i prirur që të të mësojnë të gjithë sesa të dëshirosh të mësosh atë që është më poshtë se të gjithë».<sup>[96]</sup> Dhe shtonte një këshillë për ta mbajtur larg djallin: «Duke u gëzuar për të mirën e të tjerëve si të ishte e jotja dhe duke u përpjekur sinqerisht që këta të parapëlqehen më shumë se ti në të gjitha gjërat. Në këtë mënyrë do ta mposhtësh të keqen me të mirën, do ta dëbosh larg vetes djallin dhe do të fitosh gëzimin e shpirtit. Përpiqu ta bësh këtë veçanërisht me ata të cilët të pëlqejnë më pak. Ta dish se nëse nuk do të ushtrohesh në këtë fushë, nuk do ta arrish dashurinë e vërtetë as nuk do të kesh dobi në të».<sup>[97]</sup>

118. Përvujtëria mund të rrënohet në zemër vetëm nëpërmjet përvujtërimeve. Pa to nuk ka as përvujtëri as shenjtëri. Nëse ti nuk je i aftë të durosh dhe të kushtosh disa përvujtëri nuk je i përvuajtur dhe nuk je në rrugën e shenjtërisë. Shenjtëria që Hyji i dhuron Kishës së vet vjen nëpërmjet përvujtërimit të Birit të vet: kjo është udha. Përvujtërimi të bën t'i përngjash Jezusit, është pjesë e pashmangshme e imitimit të Krishtit: «Krishti pësoi për ju

duke ju lënë shembullin që edhe ju t'i ndiqni gjurmët e tij» (1 Pjt 2,21). Ai, nga ana e vet, dëfton përvujtërinë e Atit, që përvujtërohet për të ecur me popullin e vet, që duron pabesnikëritë dhe ankimet e tij (krh. *Dal* 34,6-9; *Urt* 11,23-12,2; *Lk* 6,36). Për këtë arsye Apostujt, pas përvujtërimit, ishin «plot gëzim pse qenë çmuar të denjë të durojnë ndonjë fyerje për nder të emrit të Jezusit» (*Vap* 5,41).

119. Nuk e kam fjalën vetëm për situatën e dhunshme të martirizimit, por edhe për përvujtërimet e përditshme të atyre që durojnë për të shpëtuar familjen e tyre, ose shmangin të folurit mirë për vetveten dhe parapëlqejnë të lëvdojnë të tjerët në vend që të krenohen, zgjedhin detyrat më pak të shkëlqyeshme, dhe nganjëherë madje parapëlqejnë të durojnë diçka të padrejtë për t'ia kushtuar Zotit: «Nëse, duke bërë mirë pësoni dhe me duresë i mbartni të vështirat: kjo është hir para Hyjit» (1 Pjt 2,20). Nuk është të ecim me kokë ulur, të flasim pak apo të ikim prej shoqërisë. Nganjëherë, pikërisht sepse është i lirë prej egoizmit, dikush mund të ketë guximin të diskutojë me ëmbëlsi, të pretendojë drejtësi apo të mbrojë të dobtit para të fuqishëmve, megjithëse kjo i sjell pasojë negative për figurën e tij.

120. Nuk po them se përvujtërimi është diçka e pëlqyeshme, sepse ky do të ishte mazokizëm, por se bëhet fjalë për një rrugë për të imituar Jezusin dhe për t'u rritur në bashkimin me Të. Kjo nuk është e kuptueshme në planin natyror dhe bota e përqesh një propozim të tillë. Është një hir që kemi nevojë ta kërkojmë me lutje: "O Zot, kur vijnë përvujtërimet, më ndihmo të ndiej se gjendem pas teje, në rrugën tënde!".

121. Ky qëndrim presupozon një zemër të paqësuar prej Krishtit, të lirë prej atij agresiviteti që buron nga një *unë* tepër i madh. I njëjti paqësim, i kryer prej hirit, na lejon të ruajmë një siguri të brendshme dhe të bëjmë ballë, të qëndrojmë në të mirën «edhe në kalofsha nëpër luginën e hijes së vdekjes» (*Ps* 23,4) ose edhe nëse «çohet... edhe një ushtri e tërë kundër meje» (*Ps* 27,3). Të fortë në Zotin, Shkëmbin, mund të këndojmë: «Posa bie në shtrojë gjumi menjëherë më merr në qetësi, sepse vetëm ti, o Zot, më jep pushimin e qetë» (*Ps* 4,9). Si përfundim, Krishti «është paqja jonë» (*Ef* 2,14) dhe ka ardhur «për t'i drejtuar hapat tanë në udhën e paqes» (*Lk* 1,79). Ai i komunikoi shenjtës Faustina Kovalska se «njerëzimi nuk do të gjejë paqe derisa të mos i drejtohet me besim Mëshirës Sime».[98] Prandaj, të mos biem në tundimin që ta kërkojmë sigurinë e brendshme në sukseset, në kënaqësitë e zbrazëta, në zotërimin, në sundimin mbi të tjerët ose në imazhin shoqëror: «Po ju jap paqen time», por «nuk po jua jap siç e jep bota» (*Gjn* 14,27).

### **Gëzimi dhe ndjenja e humorizmit**

122. Çka u tha deri tani nuk kërkon një shpirt të druajtur, të trishtuar, të vrazhdë, malinkolik, ose një mediokritet pa energji. Shenjti është i aftë të jetojë me gëzim dhe ndjenjë humorizmi. Pa e humbur realizmin, i ndriçon të tjerët me një shpirt pozitiv dhe të pasur me shpresë. Të jesh i krishterë është «gëzim në Shpirtin Shenjt» (*Rom* 14,17), sepse «dashurinë në dashurinë e krishterë» e ndjek patjetër gëzimi. Meqenëse ai që do gëzohet gjithmonë prej bashkimit me të dashurin [...] Prandaj dashurinë e ndjek gëzimi».[99] Kemi marrë bukurinë e Fjalës së tij dhe e mirëpresim atë «me gëzimin që jep Shpirti Shenjt edhe pse në vështirësi të madhe» (1 *Se*/1,6). Nëse lejojmë që Zoti të na bëjë të dalim prej guaskës sonë dhe ta ndryshojë jetën tonë, atëherë do të mund ta realizojmë atë që kërkonte shën Pali: «Gëzohuni gjithmonë në Zotin, rishtas po ju them: gëzohuni!» (*Fil* 4,4).

123. Profetët e shpallnin kohën e Jezusit, që ne jemi duke e jetuar, si një zbulim të gëzimit: «Brohoritni e këndonit!» (*Is* 12,6); «Ngjitu mbi një mal të lartë, ti që i sjell sihariqin Sionit; ngrite me gjithë fuqi zërin tënd, ti që i sjell sihariqin Jerusalemit!» (*Is* 40,9); «Lavde, o male,

ju këndon, sepse Zoti po e ngushëllon popullin e vet, po ka mëshirë për varfanjakët e vet!» (Is 49,13); «Gëzo me gjithë shpirt, Bija e Sionit, galdo, bija e Jerusalemit! Ja, mbreti yt, po vjen te ti: është i drejtë e Shpëtimtar» (Zak 9,9). Dhe të mos e harrojmë nxitjen e Nehemisë: «Mos u trishtoni, sepse gëzimi i Zotit është fuqia juaj!» (8,10).

124. Maria, që ka ditur ta zbulojë risinë që ka sjellë Jezusi, këndonte: «Shpirti im me hare i brohoret Hyjit» (Lk 1,47) dhe vetë Jezusi «nën ndikimin e Shpirtit Shenjt, klithi plot hare» (Lk 10,21). Kur kalonte Ai, «mbarë populli gufonte prej gëzimit» (Lk 13,17). Pas ringjalljes së tij, aty ku shkonin nxënësit vërehej «gëzim i madh» (Vap 8,8). Neve Jezusi na jep një siguri: «Ju do të trishtoheni, por trishtimi juaj do të kthehet në gëzim. [...] Unë prapë do të vij t'ju shoh e zemra juaj do të galdojë dhe askush s'do t'ju marrë gëzimin tuaj» (Gjn 16,20.22). «Jua thashë këto, që gëzimi im të jetë në ju e gëzimi juaj të jetë i plotë» (Gjn 15,11).

125. Ka momente të vështira, kohë kryqi, por asgjë nuk mund ta shkatërrojë gëzimin mbinatyror, që «përshtatet e shndërrohet, dhe gjithmonë mbetet të paktën një rreze drite që lind prej sigurisë personale se jam pafundësisht i dashur, përtej gjithçkaje».[100] Është një siguri e brendshme, një kthjelltësi plot shpresë që jep një kënaqësi shpirtërore të pakuptueshme sipas kriterëve të botës.

126. Zakonisht gëzimi i krishterë është i shoqëruar nga ndjenja e humorizmit, aq e dukshme, për shembull, tek shën Tomas Mori, tek shën Vinçenc de Pali apo tek shën Filip Neri. Humori i keq nuk është shenjë e shenjtërisë: «Flake dhimbjen nga trupi yt» (Kish 11,10). Është kaq e madhe ajo që marrim prej Zotit «për ta gëzuar» (1 Tim 6,17), sa nganjëherë trishtimi është i lidhur me mosmirënjohjen, me të qëndruarit gjithmonë të mbyllur në vetvete aq sa të bëhemi të paafte për t'i njohur dhuratat e Hyjit.[101]

127. Dashuria e tij atërore na fton: «Bir, [...] mos e lër veten keq [...]. Mos ia moho vetes një ditë të lume» (Sir 14,11.14). Dëshiron të jemi pozitivë, mirënjohës dhe jo tepër të ndërlikuar: «Në ditë të mirë gëzoji të mirat [...]. Hyji e krijoi njeriun të drejtë, por janë njerëzit që kërkojnë arsyetime të pakufishme» (Kish 7,14.29). Në çdo situatë duhet të ruajmë një shpirt elastik, dhe të bëjmë sikurse shën Pali: «Jam mësuar të jem i kënaqur me aq sa kam» (Fil 4,11). Është ajo që jetonte shën Françesku i Asizit, i aftë të prekej prej mirënjohjes para një cope buke të fortë, ose të lëvdonte i lumtur Hyjin vetëm për puhizën që përkëdhelte fytyrën e tij.

128. Nuk jam duke folur për gëzimin konsumist dhe individualist aq të pranishëm në disa përvoja kulturore të sotme. Në të vërtetë, konsumizmi nuk bën gjë tjetër veçse rëndon zemrën; mund të japë kënaqësi të rastësishme e kalimtare, por jo gëzim. Por e kam fjalën për atë gëzim që jetohet në bashkim, që bashkëndahet dhe ndahet me të tjerët, sepse «Më i lum është ai që jep se ai që merr» (Vap 20,35) dhe «Hyji e do atë që jep me gëzim» (2 Kor 9,7). Dashuria vëllazërore e shumëzton aftësinë tonë për gëzim, sepse na bën të aftë të gëzojmë për të mirën e të tjerëve: «Gëzohuni me ata që gëzojnë» (Rom 12,15). «Ne gëzohemi kur jemi të ligsh të e ju të fortë» (2 Kor 13,9). Ndërsa, nëse «përqendrohemi sidomos në nevojat tona, e dënojmë veten të jetojmë me pak gëzim».[102]

## **Guximi dhe zelli**

129. Në të njëjtën kohë, shenjtëria është *parresia*: është guxim, është hov ungjillëzues që lë një shenjë në këtë botë. Që kjo të jetë e mundur, vetë Jezusi na përkrah dhe na përsërit me kthjelltësi dhe vendosmëri: «Mos kini frikë» (Mk 6,50). «Unë jam me ju gjithmonë – deri në të sosur të botës» (Mt 28,20). Këto fjalë na lejojnë të ecim dhe të shërbejmë me atë



qëndrim plot guxim që Shpirti Shenjt ngjallte në Apostujt duke i nxitur ata që të shpallnin Jezu Krishtin. Guximi, entuziazmi, të folurit me liri, zelli apostolik, të gjitha këto përfshihen në fjalën *parresia*, fjalë me të cilën Bibla shpreh edhe lirinë e një ekzistence që është e hapur, sepse gjendet e gatshme për Hyjin dhe për vëllezërit (krh. *Vap* 4,29; 9,28; 28,31; *2 Kor* 3,12; *Ef* 3,12; *Heb* 3,6; 10,19).

130. I lumi Pali VI përmendte mes pengesave të ungjillëzimit pikërisht mungesën e *parresia*-s: «mungesa e zellit, aq më shumë e rëndë sepse lind nga brenda».[103] Sa herë ndihemi të tërhequr që të ndalemi në bregun e rehatshëm! Por Zoti na thërret të lundrojmë në det të hapur dhe të hedhim rrjetat në ujëra më të thella (krh. *Lk* 5,4). Na fton ta shpenzojmë jetën tonë në shërbim të tij. Të kapur pas Tij kemi guximin t'i vëmë të gjitha karizmat tona në shërbim të të tjerëve. Sikur të mund të ndiheshim të nxitur prej dashurisë së tij (krh. *2 Kor* 5,14) dhe të thoshim së bashku me shën Palin: «I mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!» (*1 Kor* 9,16).

131. Le ta shikojmë Jezusin: dhembshuria e tij e thellë nuk ishte diçka që e bënte të përqendrohej në vetvete, nuk ishte një dhembshuri paralizuese, e druajtur apo plot turp ashtu sikurse shumë herë na ndodh ne, por krejt e kundërta. Ishte një dhembshuri që e nxiste të dilte prej vetes me forcën për të shpallur, për të dërguar në mision, për të dërguar që të shëronin e të lironin. Le ta pranojmë brishtësinë tonë por le të lejojmë që Jezusi ta marrë atë në duart e veta dhe të na nisë në mision. Jemi të brishtë, por bartës të një thesari që na bën të mëdhenj dhe që mund t'i bëjë më të mirë e të lumtur ata që e pranojnë. Guximi apostolik është pjesë përbërëse e misionit.

132. *Parresia* është vulë e Shpirtit, dëshmi e vërtetësisë së shpalljes. Është siguri e lumtur që na bën të mburremi me Ungjillin që shpallim, është besim i patundur në besnikërinë e Dëshmitarit besnik, që na jep sigurinë se asgjë «nuk do të mund të na ndajë prej dashurisë së Hyjit» (*Rom* 8,39).

133. Kemi nevojë për shtytjen e Shpirtit që të mos jemi të paralizuar prej frikës dhe prej interesit, që të mos mësohemi të ecim vetëm brenda kufijve të sigurtë. Të mos harrojmë se ajo që mbetet e mbyllur, në fund ka erë lagështie dhe na bën të sëmuremi. Kur Apostujt ndien tundimin që të lejonin të paralizoheshin prej frikave dhe prej rreziqeve, filluan të luteshin së bashku duke kërkuar *parresia*-n: «E tani, o Zot, shih kërcënimin e tyre e bëj që shërbëtorët e tu ta shpallin me plot guxim Fjalën tënde!» (*Vap* 4,29). Dhe përgjigjja që se «Pasi e kryen lutjen, u trand vendi ku ishin të bashkuar, të gjithë u mbushën me Shpirtin Shenjt dhe u vunë ta shpallin me guxim Fjalën e Hyjit» (*Vap* 4,31).

134. Sikurse Jona profet, gjithmonë e kemi të fshehur në ne tundimin për të ikur në një vend të sigurt që mund të ketë shumë emra: individualizëm, spiritualizëm, mbyllje në botë të vogla, varësi, sistemim, përsëritje e skemave të paracaktuara, dogmatizëm, mall, pesimizëm, strehim në normat. Nganjëherë e kemi të vështirë të dalim nga një territor që ishte i njohur dhe i afërt për ne. Megjithatë, vështirësitë mund të jenë sikurse stuhia, balena, krimbi që e bëri urthin e Jonës të thahej, ose era dhe dielli që ia dogjën kryet; dhe sikurse ndodhi me të, mund të kenë funksionin që të na bëjnë të kthehemi tek ai Hyj që është ëmbëlsi dhe që dëshiron të na drejtojë në një rrugëtim të vazhdueshëm dhe përtëritës.

135. Hyji është gjithmonë risi, që na nxit vazhdimisht të rinisemi dhe të ndryshojmë vend për të shkuar përtej të njohurës, drejt periferive dhe kufijve. Na çon aty ku gjendet njerëzimi më i plagosur dhe ku qeniet njerëzore, nën dukjen e sipërfaqësive dhe të konformizmit, vazhdojnë të kërkojnë përgjigjen ndaj pyetjes në lidhje me kuptimin e jetës.

Hyji nuk ka frikë! Nuk ka frikë! Shkon gjithmonë përtej skemave tona dhe nuk i druan periferitë. Ai vetë është bërë periferi (krh. *Fil* 2,6-8; *Gjn* 1,14). Prandaj, nëse do të guxojmë të shkojmë në periferi, atje do ta gjejmë: Ai do të jetë atje. Jezusi na paraprin në zemrën e atij vëllai, në trupin e tij të plagosur, në jetën e tij të shtypur, në shpirtin e tij të errësuar. Ai është tashmë aty.

136. Është e vërtetë se duhet t'ia hapim derën Jezu Krishtit, sepse Ai troket dhe thërret (krh. *Zb* 3,20). Por nganjëherë pyes veten nëse, për shkak të ajrit të padurueshëm të autoreferencialitetit tonë, Jezusi nuk do të jetë duke trokitur brenda nesh që ta lëmë të dalë. Në Ungjill shohim se si Jezusi «përshkoi qytete e fshatra duke predikuar e duke kumtuar Ungjillin e Mbretërisë së Hyjit» (*Lk* 8,1). Edhe pas ringjalljes, kur nxënësit u nisën në çdo drejtim, «Zoti bashkëpunonte me ta» (*Mk* 16,20). Kjo është dinamika që buron prej takimit të vërtetë.

137. Zakoni na josh dhe na thotë se nuk ka kuptim të përpiqemi t'i ndryshojmë gjërat, se nuk mund të bëjmë asgjë përballë kësaj situate, se ka qenë gjithmonë kështu dhe se megjithatë kemi ecur përpara. Për zakon ne nuk e përballim më të keqen dhe lejojmë që gjërat "të shkojnë si të shkojnë", ose ashtu si disa kanë vendosur se duhet të shkojnë. Le të lejojmë pra që Zoti të vijë e të na zgjojë, ta shkundë plogështinë tonë, të na lirojë prej inercisë. Le ta sfidojmë zakonshmerinë, t'i hapim mirë sytë dhe veshët, dhe sidomos zemrën, për të lejuar që të nxitemi prej asaj që ndodh përreth nesh dhe prej britmës së Fjalës së gjallë e efikase të të Ringjallurit.

138. Na vë në lëvizje shembulli i shumë meshtarëve, rregulltareve, rregulltarëve e laikëve që angazhohen për të shpallur e për të shërbyer me besnikëri të madhe, shumë herë duke rrezikuar jetën dhe me siguri duke hequr dorë prej rehatisë së tyre. Dëshmia e tyre na kujton se Kisha nuk ka nevojë për shumë burokratë e funksionarë, por për misionarë të apasionuar, të pushtuar prej entuziazmit për të komunikuar jetën e vërtetë. Shenjtërit na befasojnë, na çorientojnë, sepse jeta e tyre na thërret të dalim prej mediokritetit të qetë dhe anestezizues.

139. Le t'i kërkojmë Zotit hirin që të mos ngurrojmë kur Shpirti kërkon prej nesh që të bëjmë një hap përpara; le të kërkojmë guximin apostolik për t'ua komunikuar Ungjillin të tjerëve dhe për të mos e bërë jetën tonë një muze kujtimesh. Në çdo situatë, le të lejojmë që Shpirti Shenjt të na bëjë ta sodisim historinë në perspektivën e Jezusit të ringjallur. Në këtë mënyrë Kisha, në vend që të lodhet, do të mund të ecë përpara duke mirëpritur befasitë e Zotit.

## **Në bashkësi**

140. Është shumë e vështirë të luftojmë kundër epshit tonë dhe kundër kurtheve dhe tundimeve të djallit e të botës egoiste nëse jemi të izoluar. Bombardimi që na josh është i tillë sa, nëse jemi tepër vetëm, lehtë e humbim ndjenjën e realitetit, qartësinë e brendshme dhe dorëzohemi.

141. Shenjtërimi është një ecje bashkësiore, që duhet bërë dy nga dy. Kështu e pasqyrojnë disa bashkësi të shenjta. Në raste të ndryshme Kisha ka kanonizuar bashkësi të tëra që e kanë jetuar heroikisht Ungjillin ose që ia kanë kushtuar Hyjit jetën e të gjithë anëtarëve të vet. Le të mendojmë, për shembull, për shtatë themeluesit e shenjtë të Urdhrit të Shërbëtorëve të Marisë, për shtatë rregulltares e lume të manastirit të parë të Vizitës së Madridit, për shën Pal Mikin dhe shokët martirë në Japoni, për shën Andrea Taegonin dhe shokët martirë në Kore, për shenjtërit Rrok Gonzales dhe Alfons Rodriges e shokët martirë

në Amerikën e Jugut. Le të kujtojmë edhe dëshminë e kohëve të vona të murgjërve trapistë të Tibhirines (Algjeri), që janë përgatitur së bashku për martirizimin. Në të njëjtën mënyrë ka shumë çifte të shenjta bashkëshortësh, në të cilat secili bashkëshort ka qenë mjet për shenjtërimin e tjetrit. Të jetojmë dhe të punojmë me të tjerët është pa dyshim një rrugë e rritjes shpirtërore. Shën Gjoni i Kryqit i thoshte një nxënësi: je duke jetuar me të tjerët «që të të punojnë dhe të të ushtrojnë në virtyt».[104]

142. Bashkësia është e thirrur të krijojë atë «hapësirë teologale në të cilën mund të përjetohet prania mistike e Zotit të ringjallur».[105] Bashkëndarja e Fjalës dhe kremtimi i Eukaristisë së bashku na bëjnë më shumë vëllezër dhe pak nga pak na shndërrojnë në bashkësi të shenjtë e misionare. Kjo u hap rrugë edhe përvojave të njëmendta mistike të jetuara në bashkësi, siç qe rasti i shën Benediktit dhe shenjtës Skolastika, ose i atij takimi sublim shpirtëror që jetuan së bashku shën Agustini dhe nëna e tij shenjtja Monika: «Kur u afrua dita në të cilën duhej të dilte prej kësaj jete, ditë e njohur për ty, e panjohur për ne, ndodhi, me ndërhyrjen tënde, besoj unë, sipas vendimeve të tua të mistershme, që të gjendeshim ajo dhe unë vetëm, të mbështetur te një dritare që shihte nga kopshti i shtëpisë që na përbunte [...]. E hapnim me lakmi gojën e zemrës para hedhjes qiellore të burimit tënd, burimit të jetës, që është pranë teje [...]. E ndërsa flisnim dhe **prireshim drejt saj** [Urtisë], e morëm pak me hovin e plotë të mendjes [... kështu që] jeta e pasosur [do t'i përngjante] atij momenti intuitive që na bëri të psherëtimë».[106]

143. Por këto përvoja nuk janë gjëja më e shpeshtë, as më e rëndësishmja. Jeta në bashkësi, në familje, në famulli, në bashkësinë rregulltare apo në çfarëdo tjetre, është e përbërë prej shumë hollësish të vogla të përditshme. Kjo ndodhte në bashkësinë e shenjtë që formuan Jezusi, Maria dhe Jozefi, ku është pasqyruar në mënyrë paradigmatiche bukuria e bashkimit trinitar. Dhe është edhe ajo që ndodhte në jetën bashkësiore që Jezusi bënte me nxënësit e vet dhe me njerëzit e thjeshtë të popullit.

144. Le të kujtojmë se si Jezusi i ftonte nxënësit e vet të bënin kujdes ndaj hollësive. Hollësia e vogël se po mbaronte vera në një festë.  
Hollësia e vogël se mungonte një dele.  
Hollësia e vogël e vejushës që dhuroi dy monedhat e veta të vogla.  
Hollësia e vogël për të pasur vaj rezervë për dritëzat nëse dhëndri vonohet.  
Hollësia e vogël për t'u kërkuar nxënësve që të shihnin se sa bukë kishin.  
Hollësia e vogël për të pasur një zjarr të gatshëm dhe peshk mbi të ndërsa priste nxënësit në të zbardhur të dritës.

145. Bashkësia që ruan hollësitë e vogla të dashurisë,[107] ku anëtarët kujdesen për njëri-tjetrin dhe përbëjnë një hapësirë të hapur dhe ungjillëzuese, është vendi i pranisë së të Ringjallurit që e shenjtëron atë sipas planit të Atit. Nganjëherë, prej një dhurate të dashurisë së Zotit, në mes të këtyre hollësive të vogla na dhurohen përjetime ngushëlluese të Hyjit: «Një mbrëmje dimri po kryeja si zakonisht shërbimin tim të vogël, [...] papritmas dëgjova në largësi një tingull të harmonishëm të një vegle muzikore: atëherë përfytyrova një sallon të ndriçuar mirë e që shkëlqente prej arit, vajzat e veshura me elegancë që shkëmbenin me njëra-tjetrën komplimente dhe fjalë të rastit sipas zakoneve të botës; pastaj vështrimi im ra mbi të sëmurën e shkretë që mbaja; në vend të një melodie dëgjoja herë pas here ofshamat e saj ankuese [...]. Nuk mund ta shpreh atë që ndodhi në shpirtin tim, ajo që di është se Zoti e ndriçoi me rrezet e së vërtetës që e tejkalojnë aq shumë shkëlqimin e errët të festave të tokës, sa nuk mund t'i besojta lumturisë sime».[108]

146. Kundër prirjes për individualizmin konsumist që arrin të na izolojë në kërkimin e mirëqenies së veçar prej të tjerëve, ecja jonë e shenjtërimit nuk mund të reshtë së

identifikuari me atë dëshirë të Jezusit: që «të gjithë të jenë një. Sikurse ti, Atë, që je në mua dhe unë në ty» (*Gjn 17,21*).

### **Në lutje të vazhdueshme**

147. Së fundi, pavarësisht se duket e kuptueshme, le të kujtojmë se shenjtëria përbëhet prej hapjes së zakonshme ndaj transhendencës, që shprehet në lutje dhe në adhurim. Shenjti është një person me shpirt urate, që ka nevojë të komunikojë me Hyjin. Është një njeri që nuk duron t'i merret fryma në imanencën e mbyllur të kësaj bote, dhe në mes të përpjekjeve të veta e të dhurimit të vet dëshiron me gjithë zemër Hyjin, del prej vetvetes në lavd dhe i zgjeron kufijtë e vet në soditjen e Zotit. Nuk besoj në shenjtërinë pa lutje, edhe pse nuk bëhet fjalë domosdoshmërisht për momente të gjata apo për ndjenja të forta.

148. Shën Gjoni i Kryqit porosiste: «Kujdesuni të rrini gjithmonë në praninë e Hyjit, qoftë ajo reale apo imagjinare apo bashkuese, për sa ta lejojë veprimtaria!».[109] Në fund të fundit, është dëshira për Hyjin që nuk mund të mos dëftohet në njëfarë mënyre nëpërmjet jetës sonë të përditshme: «Të jeni i zellshëm në lutje pa e lënë atë pas dore as në mes të punëve të jashtme! Qoftë nëse hani apo pini, qoftë nëse flisni apo merreni me shekullarët apo bëni ndonjë gjë tjetër, dëshironi gjithmonë Hyjin duke e mbajtur në Të dashurinë e zemrës!».[110]

149. Pavarësisht prej kësaj, që kjo të jetë e mundur, janë të nevojshme edhe disa momente të kushtuara vetëm Hyjit, në vetmi me Të. Për shenjtën Terezë të Avilës lutja është «një marrëdhënie e ngushtë miqësie, një qëndrim i shpeshtë vetëm për vetëm me Atë, i cili e dimë se na do».[111] Do të doja të këmbëngul në faktin se kjo nuk është vetëm për pak njerëz të privilegjuar, por për të gjithë, sepse «të gjithë kemi nevojë për këtë heshtje plot me prani të adhuruar».[112] Lutja plot besim është një përgjigje e zemrës që i hapet Hyjit sy për sy, ku u jepet fund të gjithë zërave për të dëgjuar zërin e këndshëm të Zotit që jehon në heshtje.

150. Në këtë heshtje është e mundshme të dallojmë, në dritën e Shpirtit, udhët e shenjtërisë që Zoti na propozon. Përndryshe, të gjitha vendimet tona do të mund të jenë vetëm "dekorime" që, në vend që ta lartësojnë Ungjillin në jetën tonë, do ta mbulojnë atë dhe do t'ia marrin frymën. Për çdo nxënës është e domosdoshme të rrijë me Mësuesin, ta dëgjojë, të mësojë prej Tij, të mësojë gjithmonë. Nëse nuk dëgjojmë, të gjitha fjalët tona do të jenë vetëm zhurma që nuk shërbejnë për asgjë.

151. Le të kujtojmë se «është soditja e fytyrës së Jezusit të vdekur e të ringjallur ajo që e rindërton njerëzimin tonë, edhe atë të copëtuar prej mundimeve të jetës, ose të shënuar prej mëkatit. Nuk duhet ta manipulojmë fuqinë e fytyrës së Krishtit».[113] Pra, po i lejoj vetes të të pyes: a ka momente në të cilat vendosesh në praninë e tij në heshtje, rri me Të pa nxitim, dhe lejon që Ai të të vështrojë? A lejon që zjarri i tij ta ndezë zemrën tënde? Nëse nuk lejon që Ai të ushqejë në të ngrohtësinë e dashurisë dhe të ëmbëlsisë, nuk do të kesh zjarr, e kështu si do të mund ta ndezësh zemrën e të tjerëve me dëshminë tënde dhe me fjalët e tua? E nëse para fytyrës së Krishtit ende nuk arrin të lejosh që të shërohesh e të shndërrohesh, atëherë depërto në brendësinë e Zotit, hyr në plagët e tij, sepse aty e ka selinë mëshira hyjnore!»[114]

152. Megjithatë, lutem që të mos e kuptojmë heshtjen e uratës si një ikje që e mohon botën përreth nesh. "Shtegtari rus", që ecte në lutje të vazhdueshme, tregon se ajo lutje nuk e ndante prej realitetit të jashtëm: «Nëse më ndodhte të takoja dikë, të gjithë ata persona pa dallim më dukeshin po aq të dashur si të kishin qenë të familjes sime. [...] Jo vetëm ndieja

këtë dritë brenda shpirtit tim, por edhe bota e jashtme më dukej shumë e bukur dhe e mahnitshme».[115]

153. As historia nuk zhduket. Lutja, pikërisht sepse ushqehet prej dhuratës së Hyjit që derdhet në jetën tonë, duhet të jetë gjithmonë e pasur me kujtesë. Kujtesa e veprave të Hyjit gjendet në bazën e përvojës së besëlidhjes mes Hyjit dhe popullit të vet. Nëse Hyji ka dashur të hyjë në histori, lutja është e endur me kujtime. Jo vetëm me kujtimin e Fjalës së zbuluar, por edhe me atë të jetës sonë, të jetës së të tjerëve, të asaj që Zoti ka bërë në Kishën e vet. Është kujtesa mirënjohëse për të cilën flet edhe shën Injaci i Lojolës në veprën e vet «Soditja për të arritur dashurinë», [116] kur na kërkon të sjellim në mend të gjitha të mirat që kemi marrë prej Zotit. Shikoje historinë tënde kur lutesh dhe në të do të gjesh shumë mëshirë! Në të njëjtën kohë kjo do ta ushqejë vetëdijen tënde për faktin se Zoti të mban në kujtesën e vet dhe nuk të harron kurrë. Si rrjedhojë, ka kuptim t'i kërkojë që të ndërtojë madje edhe hollësitë e vogla të ekzistencës tënde, që Atij nuk i ikin.

154. Lutja e kërkesës është shprehje e zemrës që ka besim në Hyjin, që e di se nuk mund t'ia dalë mbanë vetëm. Në jetën e popullit besnik ndaj Hyjit gjejmë shumë lutje kërkesë plot me ëmbëlsi besuese dhe me besim të thellë. Të mos ia heqim vlerën lutjes së kërkesës, që shumë herë na e kthjellon zemrën dhe na ndihmon të ecim përpara duke luftuar me shpresë! Lutja e ndërmjetësimit ka një vlerë të veçantë, sepse është një akt besimi në Hyjin dhe njëkohësisht është shprehje e dashurisë ndaj të afërmit. Disa, për shkak të paragjytimeve spiritualiste, mendojnë se lutja duhet të jetë vetëm soditje e Hyjit, pa shpërqendrim, a thua se emrat dhe fytyrat e vëllezërve janë një shqetësim që duhet shmangur. Përkundrazi, realiteti është se lutja do të jetë më e pëlqyeshme për Hyjin dhe më shenjtëruese nëse në të, me ndërmjetësim, përqipemi të jetojmë urdhërimin e dyfishtë që na ka lënë Jezusi. Ndërmjetësimi shpreh angazhimin vëllazëror me të tjerët kur në të jemi të aftë të përfshijmë jetën e të tjerëve, ankthet e tyre më tronditëse dhe ëndrrat e tyre më të bukura. Për atë që i kushtohet zemërgjerësisht ndërmjetësimit mund të thuhet me fjalët biblike: «Ky është dashamirësi i vëllezërve, që lutet shumë për popullin» (2 Mak 15,14).

155. Nëse me të vërtetë pranojmë se Hyji ekziston, nuk mund të mos e adhurojmë, nganjëherë në një heshtje të mbushur me admirim, apo të mos i këndojmë Atij me lavd të gëzueshëm. Kështu shprehim atë që jetonte i lumi Charl dë Fuko kur tha: «Sapo besova se ekzistonte një Hyj, kuptova se nuk mund të bëja ndryshe veçse të jetoja vetëm për Të».[117] Edhe në jetën e popullit shtegtar ka shumë gjeste të thjeshta adhurimi të pastër, si për shembull kur «vështrimi i shtegtarit ndalet në një figurë që simbolizon dashurinë dhe afërsinë e Hyjit. Dashuria ndalet, sodit misterin, e shijon në heshtje».[118]

156. Leximi lutës i Fjalës së Zotit, më e ëmbël se mjalti (krh. Ps 119,103) dhe «shpatë dy tehes» (Heb 4,12), na lejon të rrimë në dëgjim të Mësuesit në mënyrë që Ai të jetë dritëz për këmbët tona, dritë për udhët tona (krh. Ps 119,105). Sikurse na kanë kujtuar mirë Ipeshkvijtë e Indisë, «devocioni ndaj Fjalës së Hyjit nuk është vetëm një ndër shumë devocione, një gjë e bukur por fakultative. I përket vetë zemrës dhe identitetit të jetës së krishterë. Fjala ka në vetvete forcën për ta shndërruar jetën».[119]

157. Takimi me Jezusin në Shkrimet na çon te Eukaristia, ku vetë Fjala arrin efikasitetin e vet më të madh, sepse është prani reale e Atij që është Fjala e gjallë. Aty i vetmi Absolut merr adhurimin më të madh që mund t'i jepet në këtë botë, sepse është vetë Krishti që kushtohet. Dhe kur e marrim në kungim, përtërijmë besëlidhjen tonë me Të dhe i lejojmë të realizojë gjithnjë e më shumë veprimin e tij shndërrues.

## KAPITULLI I PESTË

### LUFTIMI, SYÇELTËSIA DHE SHOSHITJA

158. Jeta e krishterë është një luftim i vazhdueshëm. Kërkohen forcë e guxim për t'u bërë ballë tundimeve të djallit dhe për të shpallur Ungjillin. Kjo luftë është shumë e bukur, sepse na lejon të bëjmë festë sa herë që Zoti fiton në jetën tonë.

#### **Luftimi dhe syçeltësia**

159. Nuk bëhet fjalë vetëm për një luftim kundër botës dhe mendësisë së saj, që na mashtron, na budallalleps dhe na bën mediokër, pa angazhim dhe pa gëzim. As nuk kufizohet në një luftë kundër brishtësisë sonë dhe prirjeve tona (secili ka të vetën: përtesa, fëlligështia, smira, xhelozitë, e kështu me radhë). Është edhe një luftë e vazhdueshme kundër djallit, që është princi i së keqes. Vetë Jezusi i feston fitoret tona. Ai gëzohej kur nxënësit e tij arrinin të përparonin në shpalljen e Ungjillit, duke kapërcyer kundërshtinë e të Keqit, dhe galdonte: «Shikoja kah binte Satani porsi rrufeja prej qiellit» (Lk 10,18).

#### *Diçka më shumë se një mit*

160. Nuk do ta pranojmë ekzistencën e djallit nëse do të ngulim këmbë duke e shikuar jetën vetëm me kritere empirike dhe pa një perspektivë mbinatyrore. Pikërisht bindja se ky pushtet i së keqes është në mesin tonë, është ajo që na lejon të kuptojmë se përse nganjëherë e keqja ka kaq forcë shkatërrimtare. Është e vërtetë se autorët biblikë kishin një bagazh konceptual të kufizuar për t'i shprehur disa realitete dhe se në kohët e Jezusit mund të ngatërrohej, për shembull, një epilepsi me djallosjen. Megjithatë, kjo nuk duhet të na bëjë ta thjeshtësojmë tepër realitetin duke pohuar se të gjitha rastet e treguara në ungjijtë ishin sëmundje psikike dhe se si përfundim djalli nuk ekziston apo nuk vepron. Prania e tij gjendet në faqen e parë të Shkrimeve, që përfundojnë me fitoren e Hyjit mbi djallin.[120] Faktikisht, kur Jezusi na ka lënë lutjen "Ati Ynë" ka dashur që të përfundojmë duke i kërkuar Atit që të na lirojë prej të Keqit. Shprehja që përdoret aty nuk i referohet së keqes në mënyrë abstrakte dhe përkthimi i saj më i saktë është «të Keqit». Tregon një qenie personale që na mundon. Jezusi na ka mësuar ta kërkojmë çdo ditë këtë lirim në mënyrë që pushteti i tij të mos sundojë mbi ne.

161. Prandaj, të mos mendojmë se është një mit, një paraqitje, një simbol, një figurë apo një ide.[121] Ky mashtrim na bën të mos ruhemi, ta lëmë veten pas dore dhe të rrezikojmë më shumë. Ai nuk ka nevojë të na pushtojë. Na helmon me urretjen, me trishtimin, me smirën, me veset. E kështu, ndërsa i pakësojmë mbrojtjet, ai përfiton nga kjo për të shkatërruar jetën tonë, familjet tona dhe bashkësitë tona, sepse «porsi luan ulëritës, endet andej këndeje duke kërkuar kë të përpijë» (1 Pjt 5,8).

#### *Të zgjuar dhe plot besim*

162. Fjala e Hyjit na fton haptazi që «t'u bëni ballë pritave të djallit» (Ef6,11) dhe t'i ndalim «shigjetat e zjarra të të Keqit» (Ef6,16). Nuk janë fjalë poetike, sepse edhe ecja jonë drejt shenjtërisë është një luftë e vazhdueshme. Ai që nuk do ta pranojë këtë do ta shohë veten të rrezikuar prej dështimit dhe mediokritetit. Për luftimin kemi armët e fuqishme që Zoti na jep: fenë që shprehet në lutjen, meditimin e Fjalës së Hyjit, kremtimin e Meshës, adhurimin eukaristik, Pajtimin sakramental, veprat e bamirësisë, jetën në bashkësi, angazhimin misionar. Nëse e lëmë veten pas dore do të na joshin lehtë premtimet e rreme të së keqes, sepse, siç thoshte meshtari i shenjtë Brochero: «Çfarë rëndësie ka nëse Luciferi ju premtonte

t'ju lirojë e madje edhe t'ju hedhë në mes të të gjitha të mirave të veta, nëse ato janë të mira mashtruese, nëse janë të mira të helmuara?».[122]

163. Në këtë ecje, zhvillimi i së mirës, pjekuria shpirtërore dhe rritja e dashurisë janë kundërpesha më e mirë përballë së keqes. Askush nuk reziston nëse zgjedh të ndalet në një pikë të vdekur, nëse kënaqet me pak, nëse nuk ëndërron më t'i japë Zotit një përkushtim më të bukur. Edhe më keq nëse bie në një ndjenjë mposhtjeje, sepse «ai që fillon pa besim e ka humbur që në fillim gjysmën e betejës dhe i gëpos talentet e veta. [...] Ngadhënjimi i krishterë është gjithmonë një kryq, por një kryq që në të njëjtën kohë është flamuri i fitores, që bartet me një ëmbëlsi luftëtare kundër sulmeve të së keqes».[123]

### *Prishja shpirtërore*

164. Ecja e shenjtërisë është një burim i paqes dhe i gëzimit që Shpirti na dhuron, por në të njëjtën kohë kërkon që të rrimë me "dritëza të ndezura" (krh. *Lk* 12,35) dhe të jemi të kujdesshëm: «Çdo lloji të keqeje rrijini larg» (*1 Sel* 5,22); «rrini zgjuar» (krh. *Mk* 13,35; *Mt* 24,42); të mos flemë! (krh. *1 Sel* 5,6). Sepse ata që nuk e vënë re se janë duke bërë faje të rënda kundër Ligjit të Hyjit mund ta lënë veten pre të njëfarë trulllosjeje apo plogështie. Meqenëse nuk gjejnë asgjë të rëndë për të cilën ta qortojnë veten, nuk e ndiejnë atë vaktësi që pak nga pak e pushton jetën e tyre shpirtërore dhe arrijnë të konsumohen e të prishen.

165. Prishja shpirtërore është më e keqe se sa rënia e një mëkatari, sepse bëhet fjalë për një verbëri të rehatshme dhe të vetëmjaftueshme ku në fund gjithçka duket e lejueshme: mashtrimi, shpifja, egoizmi dhe shumë forma të tjera të holla të autoreferencialitetit, sepse «edhe Satani maskohet si engjëll drite !!!!!!!!!!!!! mungon në Biblën shqip» (*2 Kor* 11,14). Kështu i përfundoi ditët e veta Salomoni, ndërsa mëkatari i madh Davidi diti ta kapërcente mjerimin e vet. Në një pjesë Jezusi na paralajmëron në lidhje me këtë tundim të fshehtë që na bën të rrëshqasim drejt prishjes: flet për një person të liruar nga djalli që, duke menduar se jeta e tij tashmë ishte e pastër, përfundoi të pushtohej prej shtatë shpirtrash të tjerë të këqij (krh. *Lk* 11,24-26). Një tjetër tekst biblik përdor një shëmbëlltyrë të fortë: «Qeni u kthye në të vjellat e veta» (*2 Pjt* 2,22; krh. *Fu* 26,11).

### **Shoshitja**

166. Si ta dimë nëse një gjë vjen prej Shpirtit Shenjt apo rrjedh prej shpirtit të botës ose prej shpirtit të djallit? E vetmja mënyrë është shoshitja, që nuk kërkon vetëm një aftësi të mirë arsyetimi dhe gjykimi, por është edhe një dhuratë që duhet ta kërkojmë. Nëse ia kërkojmë me besim Shpirtit Shenjt, dhe në të njëjtën kohë përpiqemi ta kultivojmë me anë të lutjes, reflektimit, leximit dhe këshillës së mirë, me siguri do të mund të rritemi në këtë aftësi shpirtërore.

### *Një nevojë e ngutshme*

167. Në ditët e sotme prirja për shoshitje është bërë veçanërisht e nevojshme. Në të vërtetë, jeta aktuale jep shumë mundësi veprimi e shpërqendrimi dhe bota i paraqet këto si të ishin të gjitha të vlefshme e të mira. Të gjithë, por sidomos të rinjtë, rrezikojnë nga një *zapping* i vazhdueshëm. Është e mundur të lundrojmë në dy apo tre ekrane njëkohësisht dhe të ndërveprojmë në të njëjtën kohë në skenare të ndryshme virtuale. Pa urtinë e shoshitjes mund të shndërrohemi lehtë në buratinë të nënshtruar prirjeve të momentit.

168. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur në jetën tonë shfaqet një risi, dhe prandaj duhet të shohisim nëse është vera e re që vjen prej Hyjit apo një risi mashtruese e shpirtit

të botës apo e shpirtit të djallit. Në raste të tjera ndodh e kundërta, sepse forcat e së keqes na nxisim të mos ndryshojmë, t'i lëmë gjërat ashtu si janë, të zgjedhim moslëvizjen dhe ngurtësinë, e atëherë nuk lejojmë që të veprojë fryma e Shpirtit. Jemi të lirë, me lirinë e Jezusit, por Ai na thërret ta shqyrtojmë atë që është brenda nesh – dëshirat, ngushticat, druajtjet, pritshmëritë – dhe atë që ndodh jashtë nesh – “shenjat e kohëve” – për të njohur rrugët e lirisë së plotë: «Çdo gjë shqyrtojeni me kujdes: mbani të mirën!» (1 Sel/5,21).

### *Gjithmonë në dritën e Zotit*

169. Shoshitja është e nevojshme jo vetëm në momente të jashtëzakonshme, ose kur duhet të zgjidhim probleme të mëdha, ose kur duhet të marrim një vendim të rëndësishëm. Është një mjet lufte për ta ndjekur më mirë Zotin. Na duhet gjithmonë: për të qenë të aftë t'i njohim kohët e Hyjit dhe hirin e tij, për të mos i shkuar dëm frymëzimet e Zotit, për të mos i kthyer shpinën ftesës së tij për t'u rritur. Shumë herë kjo ndodh në gjërat e vogla, në atë që duket e parëndësishme, sepse shpirtmadhësia dëftohet në gjërat e thjeshta dhe të përditshme.<sup>[124]</sup> Bëhet fjalë që të mos kemi kufizime për madhësinë, për më të mirën dhe më të bukurën, por në të njëjtën kohë të mos përqendrohemi në diçka të vogël, në angazhimin e sotëm. Prandaj u kërkoj të gjithë të krishterëve që të mos lënë pa bërë çdo ditë, në dialog me Zotin që na do, një shqyrtim ndërgjegjeje të singërtë. Në të njëjtën kohë, shoshitja na bën të njohim mjetet konkrete që Zoti cakton në planin e tij të mistershëm të dashurisë, në mënyrë që ne të mos ndalemi vetëm në qëllimet e mira.

### *Një dhuratë mbinatyrore*

170. Është e vërtetë se shoshitja shpirtërore nuk përjashton ndihmesat e dijeve njerëzore, ekzistenciale, psikologjike, sociologjike apo morale. Por i tejkalon ato. Dhe nuk i mjaftojnë as normat e urta të Kishës. Le të kujtojmë gjithmonë se shoshitja është një hir. Edhe pse përfshin arsyen dhe maturinë, i tejkalon ato, sepse bëhet fjalë për të tejparë misterin e planit të vetëm e të papërsëritshëm që Hyji ka për secilin dhe që realizohet në mes të konteksteve e kufizimeve më të ndryshme. Nuk është në lojë vetëm një mirëqenie e përkohshme, as kënaqësia për të bërë diçka të dobishme, dhe as dëshira për ta pasur ndërgjegjen të qetë. Është në lojë kuptimi i jetës sime para Atit që më njeh dhe më do, kuptimi i vërtetë, për të cilin unë mund të jap ekzistencën time, dhe që askush nuk e njeh më mirë se Ai. Pra, shoshitja çon tek vetë burimi i jetës që nuk vdes, domethënë «që të të njohin ty, Një të vetmin Hyjin e vërtetë, dhe atë që dërgove, Jezu Krishtin» (Gjn 17,3). Nuk kërkon aftësi të veçanta as nuk është e rezervuar për më të zgjuarit e të arsimuarit, dhe Ati u dëftohet me kënaqësi të përvuajturve (krh. Mt 11,25).

171. Edhe pse Zoti na flet në mënyra shumë të ndryshme gjatë punës sonë, nëpërmjet të tjerëve dhe në çdo moment, nuk është e mundur të mos marrim parasysh heshtjen e lutjes së zgjatur për ta perceptuar më mirë atë gjuhë, për të interpretuar domethënien reale të frymëzimeve që mendojmë se kemi marrë, për t'i qetësuar ankthet e për të rindërtuar tërësinë e ekzistencës sonë në dritën e Hyjit. Kështu mund të lejojmë lindjen e asaj përmbledhjeje të re që buron prej jetës së ndriçuar nga Shpirti.

### *Fol, o Zot!*

172. Megjithatë, mund të ndodhë që po në lutje ta shmangim ballafaqimin me lirinë e Shpirtit, që vepron si do vetë. Duhet të kujtojmë se shoshitja në lutje kërkon që të nisemi nga një gatishmëri për të dëgjuar: Zotin, të tjerët, vetë realitetin që gjithmonë na thërret në mënyra të reja. Vetëm ai që është i gatshëm të dëgjojë ka lirinë të heqë dorë prej këndvështrimit të vet të pjesshëm dhe të pamjaftueshëm, prej zakoneve të veta, prej



skemave të veta. Kështu është realisht i gatshëm të pranojë një thirrje që i prish siguritë e tij por që e çon në një jetë më të mirë, sepse nuk mjafton që gjithçka të shkojë mirë, që gjithçka të jetë e qetë. Ndoshta Hyji është duke na ofruar diçka më shumë, dhe në shpërndarimin tonë dembel nuk e kuptojmë.

173. Ky qëndrim dëgjimi kërkon, natyrisht, dëgjesë ndaj Ungjillit si kriter i fundit, por edhe ndaj Magjisterit që e ruan atë, duke u përpjekur të gjejmë në thesarin e Kishës atë që mund të jetë më e frytshme për të sotmen e shëlbimit. Nuk bëhet fjalë për të përdorur receta apo për të përsëritur të kaluarën, sepse të njëjtat zgjidhje nuk janë të vlefshme në të gjitha rrethanat dhe ajo që ishte e dobishme në një kontekst mund të mos jetë në një tjetër. Shoshitja e shpirtave na liron prej ngurtësisë, që nuk ka vend para të sotmes së përditshme të të Ringjallurit. Vetëm Shpirti di të depërtojë në qoshet më të errëta të realitetit dhe të mbajë parasysh të gjithë tonalitetet, që të dalë në pah me një dritë tjetër risia e Ungjillit.

### *Logjika e dhuratës dhe e kryqit*

174. Një kusht thelbësor për përparimin në shoshitje është të edukohemi me durimin e Hyjit dhe me kohët e tij, që nuk janë kurrë kohët tona. Ai nuk lë "që zjarri të zbrësë nga qielli e t'i zhdukë të pafetë" (krh. Lk 9,54), as nuk u lejon të zellshëmve "të mbledhin egjërën" që rritet së bashku me grurin (krh. Mt 13,29). Gjithashtu kërkohet bujari, sepse «më i lum është ai që jep se ai që merr» (Vap 20,35). Nuk bëjmë shoshitje për të zbuluar se çfarë tjetër mund të nxjerrim prej kësaj jete, por për të kuptuar se si mund ta kryejmë më mirë misionin që na është besuar në Pagëzim, dhe kjo kërkon që të jemi të gatshëm të bëjmë sakrifica deri në atë pikë sa të japim gjithçka. Në të vërtetë, lumturia është paradoksale dhe na dhuron përvojat më të mira kur pranojmë atë logjikë të mistershme që nuk është e kësaj bote. Siç thoshte shën Bonaventura duke folur për kryqin: «Ky është logjika jonë».[125] Nëse një njeri e merr përsipër këtë dinamikë, atëherë nuk lejon që ndërgjegjja e tij të anestetizohet dhe i hapet bujarisht shoshitjes.

175. Kur para Hyjit vrojtojmë rrugët e jetës, nuk ka hapësira që mbeten të përjashtuara. Në të gjitha aspektet e ekzistencës mund të vazhdojmë të rritemi dhe t'i dhurojmë Hyjit diçka më shumë, madje edhe në ato në të cilat përjetojmë vështirësitë më të mëdha. Por duhet t'i kërkojmë Shpirtit Shenjt që të na lirojë dhe ta dëbojë atë frikë që na bën t'ia ndalojmë hyrjen në disa aspekte të jetës sonë. Ai që kërkon gjithçka edhe jep gjithçka, dhe nuk dëshiron të hyjë në ne për të cunuar apo dobësuar, por për të dhënë plotësi. Kjo na bën të shohim se shoshitja nuk është një vetanalizë krenare, një instrospeksion egoist, por një dalje e vërtetë prej vetvetes drejt misterit të Hyjit, që na ndihmon ta jetojmë misionin në të cilin na ka thirrur për të mirën e vëllezërve.

\* \* \*

176. Dëshiroj që Maria t'i kurorëzojë këto reflektime, sepse ajo i ka jetuar si askush tjetër Lumturinë e Jezusit. Ajo është personi që kërcente prej gëzimit në praninë e Hyjit, ajo që ruante gjithçka në zemrën e vet dhe që ka lejuar ta shporojë shpata. Është shenjtja ndër shenjtër, më e bekuara, ajo që na tregon udhën e shenjtërisë dhe na shoqëron. Ajo nuk pranon që kur të biem të mbetemi përtokë dhe nganjëherë na bart në krah pa na gjykuar. Bisedimi me të na ngushëllon, na liron dhe na shenjtëron. Nëna nuk ka nevojë për shumë fjalë, nuk ka nevojë që të bëjmë përpjekje të tepërta për t'i shpjeguar se çfarë ndodh. Mjafton t'i pëshpërisim përsëri e përsëri: «Të falemi, o Mari...».

177. Shpresoj që këto faqe të jenë të dobishme në mënyrë që e gjithë Kisha të angazhohet për të nxjerrur dëshirën për shenjtëri. Le të lutemi që Shpirti Shenjt të ngjallë në ne një

dëshirë të zjarrtë për të qenë të shenjtë për më të madhen lavdi të Hyjit dhe le t'i japim zemër njëri-tjetrit në këtë qëllim. Kështu do të bashkëndajmë një lumturi që bota nuk do të mund të na e heqë.

*Dhënë në Romë, pranë Shën Pjetrit, më 19 mars, E kremtja e Shën Jozefit, e vitit 2018, i gjashti i Pontifikatit tim.*

## Franchesku

---

[1] Benedikti XVI, Homelia për fillimin kremtor të shërbesës së shën Pjetrit (24 prill 2005): AAS 97 (2005), 708.

[2] Në çdo rast supozon se ka nam shenjtërie dhe një ushtrim, të paktën në shkallën e zakonshme, të virtyteve të krishtera: krh. Let. ap. në formën e Motu proprio Maiorem hac dilectionem (11 korrik 2017), neni 2c: *L'Osservatore Romano*, 12 korrik 2017, fq. 8.

[3] Konc. II Ekum. i Vat., Kusht. dogm. Lumen gentium, 9.

[4] Krh. Joseph Malègue, *Pierres noires. Les classes moyennes du Salut*, Paris 1958.

[5] Konc. II Ekum. i Vat. II, Kusht. dogm. Lumen gentium, 12.

[6] *Verborgenes Leben und Epiphanie*: GW XI, 145.

[7] Sh. Gjon Pali II, Let. ap. Novo millennio ineunte (6 janar 2001), 56: AAS 93 (2001), 307.

[8] Let. ap. Tertio millennio adveniente (10 nëntor 1994), 37: AAS 87 (1995), 29.

[9] Homelia në Përkujtimin ekumenik të dëshmitarëve të fesë të shekullit XX (7 maj 2000), 5: AAS 92 (2000), 680-681.

[10] Kusht. dogm. Lumen gentium, 11.

[11] Krh. Hans U. Von Balthasar, "Teología y santidad", *Communio* VI/87, 489.

[12] Cantico spirituale B, Prologo, 2: *Opere*, Roma 1979, 490.

[13] Krh. *ibid.*, 14, 2: fq. 575.

[14] Krh. Katekeza në Audiencën e përgjithshme të 19 nëntorit 2014: Insegnamenti II, 2 (2014), 555.

- [15] Sh. Françesku i Salezit, *Trattato dell'amore di Dio*, VIII, 11: *Opere complete di Francesco di Sales*, IV, Roma 2011, 468.
- [16] *Cinque pani e due pesci. Dalla sofferenza del carcere una gioiosa testimonianza di fede*, Milano 2014, 20.
- [17] Konferenca e Ipeshkvijve katolikë të Zelandës së Re, *Healing love*, 1 janar 1988.
- [18] Krh. *Esercizi spirituali*, 102-312.
- [19] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 515.
- [20] *Ibid.*, 516.
- [21] *Ibid.*, 517.
- [22] *Ibid.*, 518.
- [23] *Ibid.*, 521.
- [24] Benedikti XVI, *Katekeza në Audiencën e përgjithshme të 13 prillit 2011: Insegnamenti VII* (2011), 451.
- [25] *Ibid.*: 450.
- [26] Krh. Hans U. Von Balthasar, "Teología y santidad", *Communio* VI/87, 486-493.
- [27] Xavier Zubiri, *Naturaleza, historia, Dios*, Madrid 1999<sup>3</sup>, 427.
- [28] Carlo M. Martini, *Le confessioni di Pietro*, Cinisello Balsamo 2017, 69.
- [29] Duhet të bëhet dallim mes kësaj zbatimjeje sipërfaqësore dhe një kulture të shëndoshë të pushimit, që na hap ndaj tjetrit dhe ndaj realitetit me një shpirt të gatshëm dhe soditës.
- [30] Sh. Gjon Pali II, *Homelia në Meshën e kanonizimit* (1 tetor 2000), 5: *AAS* 92 (2000), 852.
- [31] Konferenca Ipeshkvore Rajonale e Afrikës Perëndimore, *Mesazhi baritor në përfundim të Asamblesë II plenare*, 29 shkurt 2016, 2.
- [32] *La donna povera*, Reggio Emilia 1978, 375.
- [33] Krh. Kongregata për Doktrinën e Fesë, Let. *Placuit Deo* drejtuar Ipeshkvijve të Kishës Katolike në lidhje me disa aspekte të shëlbimit të krishterë (22 shkurt 2018), 4: *L'Osservatore Romano*, 2 mars 2018, fq. 4-5: «Qoftë individualizmi neo-pelagian qoftë përbuzja neo-gnostike e trupit e përcudnojnë dëshminë e fesë në Krishtin, Shëlbuesin e vetëm dhe të gjithëmbarshtëm». Në këtë dokument gjenden bazat doktrimore për kuptimin e shëlbimit të krishterë duke iu referuar rrëshqitjeve neo-gnostike dhe neo-pelagiane të sotme.
- [34] Nxit. ap. *Evangeli gaudium* (24 novembre 2013), 94: *AAS* 105 (2013), 1060.

[35] *Ibid.*: AAS 105 (2013), 1059.

[36] *Homelia gjatë Meshës në Shtëpinë e Sh. Martës*, 11 nëntor 2016: *L'Osservatore Romano*, 12 nëntor 2016, fq.8.

[37] Sikurse mëson shën Bonaventura, «është e nevojshme që të braktisen të gjitha operacionet e intelektit, dhe që kulmi i ndjenjës të zhvendoset dhe të shndërrohet krejtësisht në Hyjin. [...] Meqenëse për ta arritur këtë, natyra nuk mund të bëjë asgjë dhe shkenca mund të bëjë pak, duhet t'i japim pak peshë hetimit dhe shumë lyerjes shpirtërore; pak gjuhës dhe shumë gëzimit të brendshëm; pak fjalëve e librave, dhe krejt peshën dhuratës së Hyjit, pra Shpirtit Shenjt; pak ose aspak krijesës, dhe krejt peshën thelbit krijues, Atit, Birit e Shpirtit Shenjt» (*Itinerario della mente in Dio*, VII, 4-5).

[38] *Letër drejtuar Kancelarit të Madh të Universitetit Papnor Katolik Argjentinës për 100-vjetorin e Fakultetit të Teologjisë* (3 mars 2015): *L'Osservatore Romano*, 9-10 mars 2015, fq. 6.

[39] Nxit. ap. *Evangeli gaudium* (24 nëntor 2013), 40: AAS 105 (2013), 1037.

[40] *Videomesazhi drejtuar kongresit ndërkombëtar të Teologjisë të Universitetit Papnor Katolik Argjentinës (1-3 shtator 2015)*: AAS 107 (2015), 980.

[41] Nxit. ap. *passinod. Jeta e shuguruar* (25 mars 1996), 38: AAS 88 (1996), 412.

[42] *Letër drejtuar Kancelarit të Madh të Universitetit Papnor Katolik Argjentinës për 100-vjetorin e Fakultetit të Teologjisë* (3 mars 2015): *L'Osservatore Romano*, 9-10 mars 2015, fq. 6.

[43] *Letër drejtuar Frat Antonit*, 2: FF 251.

[44] *Mbi shtatë dhuratat e Shpirtit Shenjt*, 9, 15.

[45] Id., *Koment i Librit IV të Fjalëve të urta* 37, 1, 3, ad 6.

[46] Nxit. ap. *Evangeli gaudium* (24 nëntor 2013), 94: AAS 105 (2013), 1059.

[47] Krh. Sh. Bonaventura, *Le sei ali dei Serafini*, 3, 8: «Non omnes omnia possunt». Duhet kuptuar në linjën e *Katekizmit të Kishës Katolike*, 1735.

[48] Krh. Sh. Toma i Akuinit, *Summa Theologiae*, I-II, 109, 9, ad 1: «Tani, megjithatë, hiri është në njëfarë mënyre i papërsosur sepse – siç u tha – nuk e shëron njeriun krejtësisht».

[49] *La natura e la grazia*, 43, 50: PL 44, 271.

[50] *Rrëfimet*, 10, 29, 40: PL 32, 796.

[51] Krh. Nxit. ap. *Evangeli gaudium* (24 nëntor 2013), 44: AAS 105 (2013), 1038. (citimet e *Evangeli gaudium* janë marrë nga botimi në italisht – shën. i përkthyesit)

[52] Në kuptimin e fesë së krishterë, hiri është pararendës, shoqërues dhe ndjekës i çdo veprimit tonë (krh. Konc. Ekum. i Trentos, Seksioni VI, *Decr. de iustificatione*, kap. 5: *DH*, 1525).

[53] *Omèlie sulla Lettera ai Romani*, 9, 11: *PG* 60, 470.

[54] *Omèlia sull'umiltà*: *PG* 31, 530.

[55] Canone 4: *DH* 374.

[56] Seksioni VI, *Decretum de iustificatione*, kap. 8: *DH* 1532.

[57] N. 1998.

[58] *Ibid.*, 2007.

[59] Sh. Toma i Akuinit, *Summa Theologiae*, I-II, 114, 5.

[60] Sh. Tereza e Jezusit Fëmijë, "Kushtimi i vetvetes si Fli Shkrumbimi ndaj Dashurisë së Mëshirshme të Hyjit të Mirë" (Lutje, 6): *Opere complete*, Roma 1997, 943.

[61] Lucio Gera, "Sobre el misterio del pobre", në P. Grelot-L. Gera-A. Dumas, *El Pobre*, Buenos Aires 1962, 103.

[62] Kjo, në fund të fundit, është doktrina katolike në lidhje me "meritën" që ndjek shfajësimin: bëhet fjalë për bashkëpunimin e të shfajësuarit për rritjen e jetës së hirit (krh. *Katekizmi i Kishës Katolike*, 2010). Por ky bashkëpunim në asnjë mënyrë nuk bën që vetë shfajësimi dhe miqësia me Hyjin të bëhen objekt i një merite njerëzore.

[63] Krh. Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 95: *AAS* 105 (2013), 1060.

[64] Krh. *Summa Theologiae*, I-II, q. 107, art. 4.

[65] *Homelia në Meshën me rastin e Jubileut të personave shoqërisht të përjashtuar*, 13 nëntor 2016: *L'Osservatore Romano*, 14-15 nëntor 2016, fq. 8.

[66] Krh. *Homelia gjatë Meshës në Shtëpinë e Shën Martës*, 9 qershor 2014: *L'Osservatore Romano*, 10 qershor 2014, fq. 8.

[67] Renditja mes lumturisë së dytë e të tretë ndryshon në përkthimet e ndryshme tekstuale.

[68] *Esercizi spirituali*, 23d: Roma 1984<sup>6</sup>, 58-59.

[69] *Manoscritto C*, 12r: *Opere complete*, Roma 1997, 247.

[70] Që prej kohëve patristike Kisha e çmon dhuratën e lotëve, siç vihet re edhe në lutjen e bukur "*Ad petendam compunctionem cordis*": «O Hyj i gjithëpushtetshëm dhe tejet i butë, që ke bërë të gurgullojë prej shkëmbit një burim uji të gjallë për popullin e etur, bëj të gurgullojnë prej ngurtësisë së zemrës sonë lotë pendimi, që të mund të qajmë mëkatet tona

dhe të meritojmë, prej mëshirës sate, faljen e tyre» (*Missale Romanum*, ed. typ. 1962, fq. [110]).

[71] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 1789; krh. 1970.

[72] *Ibid.*, 1787.

[73] Përgojimi dhe shpifja janë si një akt terrorist: hidhet bomba, shkatërrohet, dhe atentatori ikën i lumtur dhe i qetë. Kjo është shumë e ndryshme prej fisnikërisë së atij që afrohet për të folur sy për sy, me sinqeritet të kthjellët, duke menduar për të mirën e tjetrit.

[74] Në disa raste mund të jetë e nevojshme të flasim për vështirësitë e ndonjë vëllai. Në këto raste mund të ndodhë që të komunikohet një interpretim në vend të një fakti objektiv. Pasioni e deformon realitetin konkret të faktit, e shndërron në interpretim dhe në fund e komunikon plot me subjektivitet. Kështu shkatërrohet realiteti dhe nuk respektohet e vërteta e tjetrit.

[75] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 218: AAS 105 (2013), 1110.

[76] *Ibid.*, 239: 1116.

[77] *Ibid.*, 227: 1112.

[78] Let. enc. *Centesimus annus* (1 maj 1991), 41c: AAS 83 (1991), 844-845.

[79] Let. ap. *Novo millennio ineunte* (6 janar 2001), 49: AAS 93 (2001), 302.

[80] *Ibid.*

[81] Bolla *Misericordiae Vultus* (11 prill 2015), 12: AAS 107 (2015), 407.

[82] Të kujtojmë reagimin e samaritanit të mirë para njeriut që cubat e kishin lënë gjysmë të vdekur në cep të rrugës (krh. *Lk* 10,30-37).

[83] Konferenca Kanadeze e Ipeshkvijve Katolikë – Komisioni për Punët Shoqërore, Letër e hapur drejtuar anëtarëve të Parlamentit, *The Common Good or Exclusion: A Choice for Canadians* (1 shkurt 2001), 9.

[84] Konferenca V e Përgjithshme e Episkopatit Latinoamerikan dhe Karaibeve, sipas magjisterit të vazhdueshëm të Kishës, ka mësuar se qenia njerëzore «është gjithmonë e shenjtë, që prej ngjizjes së saj, në të gjitha fazat e ekzistencës së saj, deri në vdekjen e saj natyrore dhe pas vdekjes», dhe se jeta e saj duhet të mbrohet «që prej ngjizjes, në të gjitha fazat e saj, deri në vdekjen natyrore» (*Dokumenti i Aparesidas*, 29 qershor 2007, 388; 464).

[85] *Regola*, 53, 1: PL 66, 749.

[86] Krh. *ibid.*, 53, 7: PL 66, 750.

[87] *Ibid.*, 53, 15: PL 66, 751.

[88] Bolla *Misericordiae Vultus* (11 prill 2015), 9: AAS 107 (2015), 405.

[89] *Ibid.*, 10: *AAS* 107 (2015), 406.

[90] Nxit. ap. *passinod. Amoris laetitia* (19 marzo 2016), 311: *AAS* 108 (2016), 439.

[91] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 197: *AAS* 105 (2013), 1103.

[92] Krh. *Summa Theologiae*, II-II, q. 30, a. 4.

[93] *Ibid.*, ad 1.

[94] *Cristo en los Pobres*, Madrid 1981, 37-38.

[95] Ka shumë forma bulizmi që, megjithëse duke u dukur elegante dhe të respektueshme, e madje shumë shpirtërore, shkaktojnë shumë vuajtje në vetëvlerësimin e të tjerëve.

[96] *Cautele*, 13: *Opere*, Roma 1979<sup>4</sup>, 1070.

[97] *Ibid.*

[98] *La Misericordia Divina nella mia anima. Diario della beata Suor Faustina Kowalska*, Qyteti i Vatikanit 1996, 132.

[99] S. Tommaso d'Aquino, *Summa Theologiae*, I-II, q. 70, a. 3.

[100] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 6: *AAS* 105 (2013), 1221.

[101] Ju porosis të thoni lutjen që i është atribuar shën Tomas Morit: «Më jep, o Zot, një tretje të mirë, si edhe diçka për të tretur! Më jep shëndetin e trupit, me humorin e mirë të nevojshëm për ta ruajtur atë! Më jep, o Zot, një shpirt të shenjtë që të dijë ta mbajë parasysh atë që është e mirë dhe e pastër, dhe të mos frikësohet para mëkatit, por të gjejë mënyrën që t'i vërë përsëri gjërat në vendin e tyre! Më jep një shpirt që nuk i njeh mërzinë, shfryrjet, ofshamat e ankimet, dhe nuk lejon që të mërzitem tepër për atë gjë aq të bezdisshme që quhet "uni"! Më jep, o Zot, ndjenjën e humorit! Më jep hirin që t'i kuptoj shakatë, që të kem në jetë pak gëzim dhe të mund t'ua komunikoj atë të tjerëve! Ashtu qoftë!».

[102] Nxit. ap. *passinod. Gëzimi i dashurisë (Amoris laetitia)* (19 mars 2016), 110: *AAS* 108 (2016), 354.

[103] Nxit. ap. *Evangelii nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 80: *AAS* 68 (1976), 73. Është interesante të vërejmë se në këtë tekst i lumi Pali VI e lidh ngushtë gëzimin me *parresia-n*. Ashtu siç tregon keqardhje për «mungesën e gëzimit dhe të shpresës», po ashtu lavdëron «gëzimin e ëmbël dhe ngushëllues të ungjillëzimit» që është i bashkuar me një «hov të brendshëm që askush, dhe as ndonjë gjë do të mund ta shuajë», me qëllim që bota të mos e marrë Ungjillin «nga ungjillëzues të trishtuar e të shkurajuar». Gjatë Vitit të Shenjtë të 1975-ës, vetë Pali VI i kushtoi gëzimit Nxitjen apostolike *Gaudete in Domino* (9 maj 1975): *AAS* 67 (1975), 289-322.

[104] *Cautele*, 15: *Opere*, Roma 1979<sup>4</sup>, 1072.

[105] Sh. Gjon Pali II, Nxit. ap. *passinod. Jeta e shuguruar* (25 mars 1996), 42: AAS 88 (1996), 416.

[106] *Rrëfimet*, IX, 10, 23-25: PL 32, 773-775.

[107] Kujtoj në mënyrë të veçantë tri fjalët-kyçe "me leje, faleminderit, më fall!", sepse «fjalët e përshtatshme, të thëna në momentin e duhur, e mbrojnë dhe e ushqejnë dashurinë ditë pas dite» (Nxit. ap. *passinod. Amoris laetitia*, 19 mars 2016, 133: AAS 108 [2016], 363).

[108] Sh. Tereza e Jezusit Fëmijë, *Manoscritto C*, 29 v-30r: *Opere complete*, Roma 1997, 269.

[109] *Gradi di perfezione*, 2: *Opere*, Roma 1979<sup>4</sup>, 1079.

[110] Id., *Consigli per raggiungere la perfezione*, 9: *Opere*, cit., 1078.

[111] *Vita di S. Teresa di Gesù scritta da lei stessa*, 8, 5: *Opere*, Roma 1981, 95.

[112] Sh. Gjon Pali II, Let. ap. *Oriente lumen* (2 maj 1995), 16: AAS 87 (1995), 762.

[113] *Fjalim në Kuvendin V kombëtar të Kishës italiane*, Firenze, 10 nëntor 2015: AAS 107 (2015), 1284.

[114] Krh. Sh. Bernardi, *Discorsi sul Cantico dei Cantici* 61, 3-5: PL 183, 1071-1073.

[115] *Racconti di un pellegrino russo*, Milano 1979<sup>3</sup>, 41; 129.

[116] Krh. *Esercizi spirituali*, 230-237.

[117] *Lettera a Enrico de Castries*, 14 gusht 1901: Charles de Foucauld, *Opere spirituali. Antologia*, Roma 1983<sup>5</sup>, 623.

[118] Konferenca V e Përgjithshme e Episkopatit Latinoamerikan dhe Karaibeve, *Dokumenti i Aparesidas* (29 qershor 2007), 259.

[119] Konferenca e Ipeshkvijve Katolikë të Indisë, *Deklarata përfundimtare e Asamblesë XXI plenare* (18 shkurt 2009), 3.2.

[120] Krh. *Homelia gjatë Meshës në Shtëpinë e Sh. Martës*, 11 tetor 2013: *L'Osservatore Romano*, 12 tetor 2013, fq. 12.

[121] Krh. Pali VI, *Katekeza në Audiencën e përgjithshme të 15 nëntorit 1972: Insegnamenti X* [1972], 1168-1170: «Një prej nevojave më të mëdha është mbrojtja prej asaj të keqeje që e quajmë Djalli. [...] E keqja nuk është më vetëm një deficiencë por një eficiencë, një qenie e gjallë, shpirtërore, e mbrapshtë dhe mbrapshtuese. Realitet i tmerrshëm. Misterioz dhe i frikshëm. Del prej kuadrit të mësimin biblik dhe kishtar ai që nuk pranon ta njohë si ekzistues; ose ai që e bën atë një parim më vete, që nuk ka, sikurse çdo krijesë, prejardhje prej Hyjit; ose e shpjegon si një pseudo-realitet, një personifikim konceptual dhe fantazioz të shkaqeve të panjohura të fatkeqësive tona».



[122] S. José Gabriel del Rosario Brochero, *Predica delle bandiere*, in Conferenza Episcopale Argentina, *El Cura Brochero. Cartas y sermones*, Buenos Aires 1999, 71.

[123] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 85: *AAS* 105 (2013), 1056.

[124] Mbi varrin e shën Injacit të Lojolës gjendet ky epitaf i urtë: «*Non coerceri a maximo, contineri tamen a minimo divinum est*» (Të mos kesh asgjë më të madhe që të të kufizojë, e megjithatë të rrish brenda asaj që është më e vogël: kjo është hyjnore).

[125] *Sull'Hexaemeron*, 1, 30.

---